



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Histori-Gjeografi”

ofruar nga

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Assoc. Dr. Nevila Çinaj

Prof. Assoc. Dr. Jostina Dhimitri

Shtator / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Histori-Gjeografi"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Histori-Gjeografi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë e Ministrisë Arsimit Nr.4964/3 prot, datë 12.11.1991
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i MASH Nr. 334, datë 13.07.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (Gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020-2021 12 PAE / 7 PAK 2021-2022 12 PAE / 6 PAK 2022-2023 11 PAE / 7 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 3 studentë; 2021-2022 5 studentë; 2022-2023 15 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër është institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 4, datë 08.01.1971. Universiteti “Eqrem Çabej”, zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Universiteti “Eqrem Çabej”, ka kaluar procesin e vlerësimit institucional periodik, me Vendim të BA Nr. 55, datë 6.12.2021, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 15/12/2025. Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër është i organizuar në 3 Njësi Kryesore, konkretisht:


1. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
2. Fakulteti i Shkencave të Natyrore;
3. Fakulteti Ekonomik;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit të ciklit të parë të studimeve, “Bachelor” në Histori-Gjeografi”, licensuar sipas Shkresës së Ministrisë Arsimit Nr.4964/3, datë 12.11.1991, që realizohet me 180 kredite në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë dhe me kohëzgjatje normale 3 (tri), vite akademike, 6 semestra.

Programi i studimit, “Bachelor” në Histori-Gjeografi” ofrohet nga **Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë**, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.

FESHSH është i organizuar në gjashtë departamente:

1. Departamenti i Gjuhës Shqipe;
2. Departamenti i Letërsisë Shqipe;
3. Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë;
4. Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
5. Departamenti i Gjuhës, Letërisë dhe Qytetërimit Grek;
6. Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;


Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit “Bachelor” në Histori-Gjeografi (ish-dega Histori-Gjeografi), të ofruar nga Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Prof. Assoc. Dr. Jostina Dhimitri** dhe **Prof. Assoc. Dr. Nevila Çinaj**. Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL-it, Znj. Alma Arapi.

Vizita 2 ditore në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër u realizua gjatë datave 20-21 Nëntor 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër (Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë). Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02.09.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 85 / 42 Prot, datë 02.09.2024. Universiteti, “Eqrem Çabej” Gjirokastër njofton në ASCAL më datë 09.09.2024, me anë të shkresës me Nr.1269/1 Prot, datë 06.09.2024 “ Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Histori-Gjeografi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër (UGJ) është një institucion publik i arsimit të lartë, hapur me VKM-në Nr. 04, datë 08.01.1971 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr. 55, datë 16.12.2021, për një afat 4 vjeçar, deri më 15/12/2025. Mbështetur në dokumentet institucionale si Statuti i UGJ, Rregullore e brendshme e UGJ, përkatësisht në <i>Nenet 7 dhe 8</i> institucioni garanton ofrimin e programeve të studimit në përputhje me interesat kombëtare që ruajnë dhe forcojnë vlerat akademike e kulturore kombëtare. <i>Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca I.19</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programet që ofron UGJ, nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit. Bazuar në statutin dhe rregulloren e UGJ, programet e ofruara nga UGJ synojnë përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme dhe janë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e UGJ. Ajo fokuson veprimtarinë e saj në tri drejtime kryesore, atë të shkencave të edukimit dhe shoqërore, shkencave ekonomike, shkencave natyrore, në këtë kuadër edhe programet janë në këto drejtime studimi. <i>RVB: Evidenca 1; Evidenca 2, Evidenca 3; Statuti i UGJ, neni 4; Evidenca 5</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe	Programi i studimit bachelor në “HGJ”, hartohet dhe ofrohet në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimin e UGJ-së, FESHSH si dhe fushën e veprimtarisë se tyre. Misioni i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër dhe i Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si ndër Njësitë Kryesore

<p>Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>të universitetit, është të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrah aspiratat arsimore dhe arritjet e çdokujt, që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë</p> <p><i>RVB: Evidenca 1; Evidenca 2, Evidenca 3; Statuti i UGJ, neni 4; Evidenca 5</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar dhe RVB, GVJ konstaton se, UGJ ka përvojën, kapacitete logjistike dhe burimet njerëzore të duhura për të ofruar programin e studimit bachelor në “Histori-Gjeografi”.</p> <p><i>RVB; Vizita në institucion; Evidenca 1.5; Evidenca 1.6; Evidenca 1.19</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Histori-Gjeografi”, është hartuar dhe ofrohet për studentët në përputhje dhe në zbatim të Strategjisë së Zhillimit të Institucionit, UGJ 2020-2025, Statutin e Universitetit, Strategjinë e Zhvillimit Shkencor, Strategjinë e Nderkombetarizimit, Planin strategjik të zhvillimit të FESHSH dhe të DHAGJ, Rregulloren e programit të studimit. Referuar vizionit të UGJ-së synohet që institucioni të përgatisë specialistë të kualifikuar të fushave përkatëse ku ofron edukim, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë në mënyrë që institucioni t’i përgjigjet detyrave që burojnë nga procesi i Bolonjës, të pasqyruara këto në Strategjinë e Zhvillimit të UGHJ-së. Në zbatim të Planit strategjik të zhvillimit të programit të studimit, synohet që realizimi i programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi” të përgatisë specialistë të kualifikuar në përputhje me parametrat ndërkombëtarë, me qëllim që të plotësojë nevojat e tregut arsimor shqiptar me burime njerëzore kualitative.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011), Trajnimit të KSNA-së (KSNA-F 2013) dhe legjislacionit në fuqi për kodifikimin, bazuar në Nenin 86, të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.5.2022 “Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave.</p>




	<i>Evidenca I.1;I.2. I.3, Evidenca I.4; Evidenca I.9, Evidenca I.20; Evidenca I.21; Evidenca I.10; Evidenca I.22; Evidenca I.23;</i>			
Konkluzione	<i>Nga RVB dhe dokumentacioni plotësues GVJ konstaton se, programi i studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi" është në përputhje me misionin, qëllimin e tij dhe me fushën akademike të Departamentit të Historisë, Antopologjisë dhe Gjeografisë, FESHSH, UGJ dhe synon të ruaj interesat dhe vlerat kombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë (UGJ) është një institucion publik me një jetëgjatësi prej më shumë se 50 vitesh dhe kjo përbën një përvojë të konsidueshme në ndarjen e detyrave për mbarëvajtjen e programeve dhe të programit që kemi nën akreditim.</p> <p>Nga takimet me drejtuesit, na u vu në dukje se Institucioni ka evoluar dhe tregon përmirësime në këtë drejtim, sidomos pas përvojës shumë të mirë në Akreditimin Institucional, por dhe në akreditimet e programeve që sapo kanë filluar. Në takimet në institucion na u theksua edhe ndihma e madhe që i ka dhënë ASCAL në shumë nga problematikat që kanë hasur në këtë drejtim apo dhe në të tjera. Takimi me Koordinatorin Institucionale të UGJ.</p> <p>Sipas dokumentacionit që GVJ konsultoi, RVB-së dhe takimeve në institucion, vumë re se në ndarjen e detyrave në mbarëvajtjen e programit, Institucioni është mbështetur në Statutin dhe rregulloren e përgjithshme të UGJ, në rregulloren e FESHSH dhe në rregulloren e DHAGJ. Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit, bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet. Disa anëtarë të personelit akademik mbulojnë pozicione të ndryshme</p>




	<p>në strukturën e institucionit ose në komisione të ngritura për tematika të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca 1 Statuti i UGJ.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 2 Rregullore e brendshme e UGJ.pdf</i></p> <p><i>RVB; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni (UGJ) në funksion të programeve të tij të studimit ka bashkëpunime me disa Universitete brenda dhe jashtë vendit. Në funksion të programit të studimit BSC në “Histori-Gjeografi”, për të realizuar objektivat e këtij programi, në RVB ashtu dhe në dokumentacionin e paraqitur, ka shumë marrëveshje, 126 MV, nga të cilat pjesa më e madhe janë me universitet të huaja, agjenci publike dhe private. Ky angazhim i institucionit për të rritur bashkëpunimin në zonën ndërkombëtare të universiteteve është një mundësi e mirë për intesifikimin e procesit të ndërkombëtarisimit nga njëra anë por në ana tjetër bie në sy një numër shumë i vogël marrëveshjesh me universitet shqiptare publike dhe jopublike (MV vetëm me UT, UBT, UET, Universiteti “Polis” e Universiteti “Barleti”).</p> <p><i>Mbështetur në sa më sipër, <u>GVJ sygjeron</u> krahas nënshkrimit të marreveshjeve me univeristete të huaja të rritet numri i nënshkrimit të marreveshjeve me universitet kombëtare publike dhe jo publike për të rritur efikasitetin e kërkimit shkencor në nivel kombëtar dhe rajonal dhe për të krijuar një rrjet kombëtar të kërkuesve shkencor, të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë në përthithjen e projekteve kombëtare të ofruara nga AKKSHI, MAS.</i></p> <p><i>RVB; Evidenca I.31; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Edhe pse numri i marrëveshjeve të nënshkruara me institucione të huaja dhe vendase, është i lartë, <i>GVJ nuk ka mundur të identifikojë</i> se cilat prej këtyre marrëveshjeve janë në funksion të programit të studimit dhe cilat janë vënë në shfrytëzim në funksion të realizimit të praktikave profesionale, praktikave të punës apo stazhit.</p> <p><i>RVB; Evidenca I.31;</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte</p>	<p>Institucioni harton raporte periodike, ku merr në analizë përfitimet nga marrëveshjet dhe mobilitet e personelit akademik Evidenca 1.17; Evidenca 1.18; Evidenca 1.33, por lidhur me, hartimin e raporteve specifike analitike të</p>





<p>analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit GVJ nuk konstatoi ndonjë të tillë.</p> <p><i>GVJ mirëkupton vështirësitë që has institucioni në bashkëpunime specifike për programin Bachelor në "Histori-Gjeografi", por gjithashtu rekomandon që të gjitha veprimtaritë që kryhen (aq sa janë deri tani, por që në të ardhmen mund të shtohen) në kuadër të realizimit të proceseve akademike dhe administrative në funksion të programit të studimit, të ruhen, administrohen, analizohen dhe raportohen në përputhje me aktet e brendshme të miratuara nga ana e institucionit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se UGJ ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucione të huaja të arsimit të lartë, gjithashtu edhe me biznese vendase e të huaja me qëllim aftësimin e zhvillimin profesional të studentëve por edhe shfytëzimin e tyre në funksion të kërkimit dhe shkëmbimit shkencor. Por, gjithashtu konstatohet se numri i marrëveshjeve me IAL kombëtare publike dhe jopublike është shumë i vogël. Për këtë rekomandojmë nënshkrimin e marrëveshjeve me IAL publike dhe jopublike kombëtare dhe hartimin nga ana e DHAGJ të raporteve periodikë ku të pasqyrohen aktivitetet që rrjedhin nga këto marrëveshje në funksion të programit të studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi".</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Histori-Gjeografi ” është hapur për herë të parë në 1991. Programi i studimit ofrohet nga departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë FESHSH, i referohet nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (<i>e thënë edhe më lart</i>) dhe organizohet në 180 ECTS. Programi është me kohë të plotë dhe realizohet në 3 vite akademike të ndarë në 6 semestra, me nga 15 javë secili Evidenca I.9, të cilat ndahen në lëndë/module bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “<i>Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë</i>” e ndryshuar dhe rregulloren e programit të studimit. Evidenca I.10; RVB</p> <p>Kurrikula është e orientuar nga kërkesat e tregut të punës dhe është ndërtuar nga një numër i mjaftueshëm disiplinash mësimore të grupuara në module bazë, karakterizuese, integruese, etj. Kurrikula ofron një formim bazë të ekuilibruar duke mundësuar kompetenca të shumfishta për t’iu përshtatur profileve të ndryshme të punës (histori gjeografi etj.)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, përmban një informacion të plotë në fushën e Historisë-Gjeografisë, por edhe të didaktikës. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive në fushat specifike dhe të specializuara që ky program i ciklit të parë të studimeve ofron si dhe në përfitim të aftësive profesionale dhe kompetencave për t’i shërbyer më mirë tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit reflekton nevojat që ka tregu dhe ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Me njohuritë e fituara në këtë program studimi, studentët kanë mundësi të përshtaten me kërkesat e tregut të punës dhe për të zgjeruar njohuritë e tyre profesionale në studime të mëtejshme në ciklet pasardhëse.</p> <p>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE; Evidenca I.10; EVIDENCA II.2. EVIDENCA II.3; EVIDENCA II.4</p>




<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi” është hartuar në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” e ndryshuar. Lëndët janë të shpërndara sipas kategorive A, B, C, D dhe E. Ato janë shpërndarë sipas përqindjeve të parashikuara në këtë VKM. Kategoria e Disiplinës D nga përlllogaritjet rezulton të jetë në përqindje më të vogël se pragu minimal, 9,4% nga (10-15%) që është në VKM. Aneks Tabela Përmbledhëse 10.2</p> <p>Referuar planit mësimor sipas modelit të Tabelës 10.2 viti akademik 2021-2022 rezulton se, lëndët me zgjedhje jepen si mundësi për zgjedhje nga studentët vetëm në vitin e dytë të këtij cikli dhe vetëm në semestrin e parë.</p> <p><i>Që mundësitë e studentëve për të zgjedhur lëndë të mos jenë të kufizuara vetëm në një vit akademik <u>GVJ sygjeron</u> që lëndët me zgjedhje të rishpërndahen në të tri vitet akademike dhe midis semestrave. Gjithashtu të përmirësohet pesha e e disiplinës D duke iu afruar vlerës së pragut referues sipas VKM Nr.41.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi” përcakton kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmblylëse: praktika mësimore që zhvillohet në terren dhe ka gjithsej 3 (tre) kredite/ECTS dhe detyrimet përmblylëse 6 kredite/ECTS.</p> <p>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar rregullores së UGJ-së dhe rregullores së programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi” rezulton se forma e organizimit të studimeve është me kohë të plotë. Këto dokumente përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Nga shqyrtimi i vendimeve të senatit akademik për bursat GVJ u njoh me format e financimit të studentëve, të cilat përfshijnë financimin nëpërmjet bursave dhe nëpërmjet përjashtimit nga tarifatat e studimit. Financimi bëhet për dy kategori.</p> <p>A. Financimi për studentët me rezultate të shkëlqyera; B. Financimi i studentëve përfitues sipas kriterëve të tjera të vendosura me aktet nënligjore.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse, sipas vendimit të Bordit të Administrimit të UGJ.</p>




	Evidenca: RVB; Evidenca I.9; Evidenca I.2; Evidenca II.5; Evidenca II.6
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi” GVJ konstatoi se, plani mësimor ka përmbajtje të ngjashme deri në masën 70% me programe të tjera me të njëjtin emërtim, të cilat ofrohen nga Universiteti i Tiranës, Elbasanit, Korçës, Shkodrës dhe Vlorës. Ky fakt u rikonfirmua nga GVJ edhe në takimet që pati me përgjegjësen e DHAGJ dhe personelin akademik, gjatë vizitës në institucion, sipas të cilëve DHAGJ është përfaqësuar në grupet e punës që Ministria e Arsimit dhe Sportit ka ngritur për rishikimin dhe përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë me anëtarët e tij, për përafrimin e programeve të mësuesisë në masën 70%. Evidenca II.7; RVB; Takim me Përgjegjësen e DHAGJ dhe personelin akademik; Vizita në institucion
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues GVJ konstaton se DHAGJ ka bërë propozimin për kodifikimin kombëtar të programit të studimit “Bachelor” në Histori-Gjeografi dhe është në pritje të miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Gjatë vizitës në institucion përgjegjësjë e DHAGJ sqaron se në përfundim të kodifikimit të programit do të vazhdohet me kryerjen e kodifikimit të lëndëve të programit të studimit. RVB; Evidenca I.22; Evidenca I.23; Takim me Përgjegjësen e DHAGJ dhe personelin akademik; Vizita në institucion
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Aktualisht programi i studimit bachelor në “Histori-Gjeografi” nuk bën pjesë në kategorinë e programeve të përbashkëta midis dy apo më shumë institucioneve. <i>Nga takimi në instiucion me drejtuesit e tij GVJ i’u deklarua se kjo është sfida për të ardhmen.</i>
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues GVJ konstaton se, programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi. Ajo që rekomandohet për tu përmirësuar nga GVJ është se lëndët me zgjedhje të rishpërndahen në të tri vitet akademike dhe midis semestrave dhe gjithashtu, të përmirësohet pesha e e disiplinës D duke iu afruar vlerës së pragur referues sipas VKM Nr.41.</i>





Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë në FESHSH, si përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, i përbush detyrimet ligjore për akreditimin e programit, pasi ka në përbërjen e tij 12 personel akademik efektiv (PAE) dhe 16 personel akademik me kontratë (PAK), 1 personel ndihmës akademik. Në total, departamenti ka në përbërjen e tij 29 personel akademik dhe ndihmës akademik. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore përbëhet nga gjashtë departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Gjuhës Shqipe; 2. Departamenti i Letërsisë Shqipe; 3. Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë; 4. Departamenti i Gjuhëve të Huaja; 5. Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek; 6. Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies; <p>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në UGJ, si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit ka angazhuar gjatë vitit 2022-2023 duke evidentuar 53 pedagogë efektivë, 31 pedagogë me kontratë dhe 1 personel ndihmës akademik. Sipas Statutit të UGJ,</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në 3 vitet e fundit, rezulton me të dhënat si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Personeli i angazhuar në DHAGJ</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof Dr</td> <td>5</td> <td>6</td> <td>4</td> <td>6</td> <td>5</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Prof.Assoc</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/Doc</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>2</td> <td>5</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>12</td> <td>16</td> <td>13</td> <td>13</td> <td>13</td> <td>11</td> </tr> </tbody> </table>	Personeli i angazhuar në DHAGJ	2022-2023		2021-2022		2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof Dr	5	6	4	6	5	4	Prof.Assoc	3	2	4	2	4	2	Dr/Doc	2	3	2	2	2	2	Msc	2	5	3	3	2	3	Në total	12	16	13	13	13	11
Personeli i angazhuar në DHAGJ	2022-2023		2021-2022		2020-2021																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof Dr	5	6	4	6	5	4																																											
Prof.Assoc	3	2	4	2	4	2																																											
Dr/Doc	2	3	2	2	2	2																																											
Msc	2	5	3	3	2	3																																											
Në total	12	16	13	13	13	11																																											

	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në departament (RVB-DVV) raporti personel akademik efektiv me personelin akademik me kontratë është 45% PAE me 55% PAK. Personel akademik efektivë mbulojnë 69.7% (1,518 orë) të ngarkesës së programit mësimor, Personel akademik e ftuar 30.3 % (659 orë) të ngarkesës mësimore.</p> <p>GVJ konstaton se bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, në të cilin është përcaktuar se në procesin e mësimdhënies duhet të përfshihet personel akademik me një formim më të lartë se cikli paraardhës, DHAGJ e përmbush këtë kriter ligjor. Por numri i PAK që angazhon DHAGJ në raport me PAE është shumë i lartë. <i>Për këtë GVJ sygjeron përmirësimin e këtij raporti duke rritur numrin e PAE në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmëri në të ardhmen.</i></p> <p>Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë (UGJ) është një institucion publik i arsimit të lartë, hapur me VKM-në Nr.04, datë 08.01.1971 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr.55, datë 16.12.2021, për një afat 4 vjeçar, deri më 15/12/2025, për një afat 4 vjeçar, deri më 15/12/2025.</p> <p>Aneks Tabela Përmbledhëse, Tabela 4;</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dëshmohet se pranë DHAGJ është i anagzhuar personeli ndihmës akademik në kategorine laborant, i cili organizon dhe përgatit mjedise laboratorike ,punën për organizimin e praktikave mësimore në laborator, por edhe në në terren. Angazhimi i personelit ndihmës akademik është në përputhje me kriteret e kualifikimit që kërkohen për këtë pozicion pune.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësin e takimit me personelin ndihmës akademik dhe vëzhgoi përgatitjen e laboratorit.</p> <p>Evidencë: Aneks Tabela Përmbledhëse, Tabela 2.1,2.2, 2.3.</p> <p>Takim me personelin ndihmës akademik;</p> <p>Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit, tabelat përmbledhëse, konstaton se nuk ka personel akademik të nominuar si koordinator i programit të studimit Bachelor në Histori-GJeografi. Nga RVB mësohet se, rolin e tij e luan Përgjegjësi i Departamentit që administron programin e studimit.</p> <p><i>GVJ sygjeron caktimin e një personeli akademik nga anëtarët e njësisë bazë për kryerjen e kësaj detyre që do të jetë më përmbushje të këtij kriteri për të arritur standartet e kërkuara lidhur me</i></p>





zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<i>sigurimin e cilësisë programit të studimit në përputhje me kodin e cilësisë.</i> Aneks Tabela Përmbledhëse, Tabela 2.1,2.2, 2.3.			
Konkluzione	<i>DHAGJ që është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi" përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. GVJ konstaon se numri i PAK që angazhon DHAGJ në raport me PAE është shumë i lartë. Për këtë GVJ <u>sygjeron</u> përmirësimin e këtij raporti duke rritur numrin e PAE në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmëri në të ardhmen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor "Histori-Gjeografi" është DHAGJ. Në gjithë aktivitetin e tij, në realizimin e përgjegjësisë për ecurinë e programit të studimit, kjo njësi mbështetet në aktet ligjore e nënligjore, të prodhuara për këtë qëllim. Konkretizimi i këtij aktiviteti dëshmohet nga dokumentacioni që iu vu në dispozicion GVJ. Në departament ishin të depozituara plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit dhe Lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mësimdhënie në këtë program studimi. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: I.1, I.2, I.20, I.10, II.2, II.3, II.4, II.16, II.17, II.18, II.19, II.20, II.8.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët	Referuar tabelave 10.1, 10.2 programi i studimit Bachelor "Histori-Gjeografi" përmban informacionet që lidhen me ndarjen e lëndëve në semestra, kredite, orë në javë, leksione, seminare orët në auditor dhe praktika në terren. Nuk jepet informacion për shumën e orëve jashtë auditori dhe orët në laboratorë duke mbajtur në konsideratë që lënda "Bazat e SIG-ut", "Bazat e Gjeologjisë" dhe "Elemente të Hartografisë" janë lëndë që më së shumti duhet të zhvillohen në laboratorë.




në auditor/jashtë auditorit.	<i>Aneks-Tabelat Përmbledhëse.Tablat Përmbledhëse, Tabela 10.1; 10.2</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit është lehtësisht i mundur të krahasohet me programe nga institucionet vendase dhe ndërkombëtare për fushën e historisë dhe gjeografisë. Këtë e mundësojnë lëndët brenda kurrikulës, pesha e tyre si dhe përmbajtja. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Bachelor në “Histori-Gjeogarfi” i ka të gjitha informacionet e nevojshme për secilën lëndë (syllabuset) ku jepen, sipas kërkesave ligjore: titullari i lëndës, ngarkesa e përgjithshme dhe e detajuar për orët në auditor (leksione seminare/ushtrime, laboratore/praktika), tipologjia e lëndës, viti akademik dhe semestri kur zhvillohet. Po ashtu, çdo syllabus përmban edhe temat e mësimave, formën e kontrollit të dijeve, detyrimin për frekuentimin si dhe literaturën (të klasifikuar si literaturë bazë dhe e rekomanduar). GVJ i konsultoi të gjitha syllabuset e lëndëve të kurrikulës dhe konkludon që ato janë konform formateve të miratuara. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: II.2, II.3, II.4</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ, gjatë takimit me personelin akademik, u interesua të informohej lidhur me nevojat për përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm të planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve. Titullarët e lëndëve konfirmuan që në përvojën e këtyre 4 viteve ndryshimet janë të vogla, por ata janë në kontakt me zhvillimet më të reja në këtë fushë, edhe do ti reflektojnë ndryshimet edhe nëpërmjet propozimeve për ndryshime në kurrikul edhe në përmbajtjen e syllabuseve. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: II.2, II.3, II.4</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se, DHAGJ ka paraqitur informacion të bollshëm nëpërmjet të cilit argumentohet organizimi, struktura dhe përmbajtja e PS BCH në “HGJ”. Referuar këtyre dokumenteve plani mësimor është në përputhje me kërkesat dhe përmban informacion për lëndët, ndarjen e tyre sipas krediteve, semestrave, orët në terren e në auditor, laboratorët, praktikant në</i>





	<i>terren. Gjithashtu informacioni për pranimin e studentëve, transferimet e tyre janë të detajuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4


Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ konstaton që dizenjimi i kurrikulës përmbajtja e veprimtarive si dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë thellim të njohurive, të aftësive dhe punësimin e studentëve. Këtë na e pohuan vetë studentët gjatë takimit me to. Plotësimin e këtij kriteri e dëshmon gjithashtu edhe punësimi i të diplomuarve të këtij programi studimi. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: II.2; Evidenca II.3; Evidenca II.4</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Lëndët e programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi” janë të shpërndara në semestra (gjithsej 6) dhe në vite akademike (gjithsej 3). Në kredite ngarkesa semestrale është si vijon: <i>Semestri i I</i> 30 ECTS; <i>Semestri i II</i> 30 ECTS; <i>Semestri III</i> 30 ECTS; <i>Semestri i IV</i> 30 ECTS; <i>Semestri i V</i> 30 ECTS; <i>Semestri i VI</i> 30 ECTS; Ndërsa ngarkesa vjetore është 60 ECTS për secilin vit. Zgjedhja e tipologjisë së lëndëve, shpërndarja e ngarkesës në aktivitete mësimore (leksione, ushtrime/seminare, laboratore/ praktika) si dhe praktika profesionale bashkë me punimin e diplomës i mundësojnë studentit arritjen e objektivave formues dhe rezultateve të pritshme si të të nxënit ashtu dhe aftësimin profesional.

	<p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Aneks Tabelat Përmbledhëse-Tabela 9</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ e konsultoi strukturën e programit, lëndët dhe shpërndarjen e tyre edhe me synim shqyrtimin e raportit teori/praktikë. Ai konstatoi që praktika profesionale (në terren) ka peshë prej 3 ECTS që përbën 1.6 % të peshës së ngarkesës së studimit, çfarë për programin e studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi” konsiderohet normë e vogël. Me 3 ECTS, duke llogaritur sipas normave Evropiane 25 orë pune të studentit për një ECTS praktikë profesionale, studenti duhet të bëjë 75 orë pune, ose përkthyer në ditë, 9.3 ditë pune (ndërsa semestri zgjat 15 javë – ose tre muaj).</p> <p>GVJ konsideron se pesha në kredite e punës praktike është shumë e ulët. Duhet theksuar se brenda lëndëve ka edhe punë laboratorike si dhe vizita me karakter profesional, gjë që e rrit efektin e praktikës.</p> <p><i>GVJ sygjeron rishikim të programit mësimor, për të rritur peshën në kredite të praktikës mësimore.</i></p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Aneks Tabelat Përmbledhëse-Tabela 9</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Referuar, <i>Tabelat Përmbledhëse-Tabela 9.1 dhe 9.2 konstatohet se ndarja e veprimtarive formuese në programin e studimit bachelor në “Histori-Gjeografi”, janë kryer duke ruajtur raportet midis lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmblyëse. Ato mdësojnë realizimin e objektivave jo vetëm lëndorë por edhe ato të përgjithshëm në kuadër të programit të studimit. Lidhur me raportet midis formimit teorik dhe praktik konstatohet se përveç praktikës në terren, nuk pasqyrohen orë që realizohen në zërat ushtrime dhe laborator. Gjithashtu, gjatë verifikimit të <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse-Tabela 9. GVJ konstaton se në planin mësimor nuk ka orë të zhvilluara në kategorinë seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor dhe të pasqyruara në syllabuset e lëndëve përkatëse.</i></i></p> <p>GVJ konsultoi në mënyrë të veçantë kurrikulën e programit dhe syllabuset e lëndëve, inspektoi ambientet ku zhvillohet mësimi dhe laboratorët, u njoh me marrëveshjet për kryerjen e praktikave profesionale si dhe elementët e mikrotezës dhe konkludon që raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: II.2, II.3, II.4.</i></p>




<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimet në institucion me personelin akademik si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konkludon se ndryshimet në programet e lëndëve janë të vogla dhe se miratimi i teksteve kryhet në mbledhje të hapura të DHAGJ. Nga shqyrtimi i listës së teksteve të miratuara për tu përdorur gjatë zhvillimit të programit të studimit vërehet se autorët janë të gjithë shqiptarë dhe jo të pesë viteve të fundit.</p> <p><i>GVJ sygjeron pasurimin me literaturë bashkëkohore, vendase dhe të huaj në mënyrë që programi I studimit të përmbushë paisjen e studentëve me kompetenca bashkëkohore në përputhje me nevojat e tregut.</i></p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: II.2, II.3, II.4. Evidenca II.29</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve që strukturojnë programin e studimit bachelor në “Histori-Gjeografi” tregojnë për përcaktimin e qartë të objektivave dhe koncepteve kyçe që personeli akademik do të trajtojë dhe do të realizojë për këtë program. Përmbajtjet e tyre siguron mjaftueshëm përfitimin e dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore, çfarë kërkohet nga programet e ciklit të parë Bachelor. Shpërndarja e lëndëve dhe raportet midis kategorisë së fushës së gjeografisë dhe historisë është në balancë dhe garanton marrjen e njohurive në fushën e gjeografisë fizike dhe humane. Po ashtu edhe në fushën e historisë, këtu theksi I vihet më shumë Historisë së Shqipërisë.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Tabela Përmbledhëse, Tabela 9.1, Evidencat: II.2, II.3, II.4.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi I studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi” u mundëson studentëve të marrin njohuri dhe të fitojnë kompetenca profesionale në procesin e krijimit, administrimit, vleresimit, analizës e vizualizimit të të dhënave hapsinore në mënyrë që ata të krijojnë modele tematike për proceset e dukuritë gjeohapsinore si përdorimi i territorit, planifikimi urban, zhvillimet në sektorin e statistikave, turizmit, kadastrës etj. Duke konsideruar zhvillimet e shpejta dhe të pandërprera në këto fusha, konkludohet që kërkohet studim në vijimësi për punësim në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat II.2, II.3, II.4.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se, struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve.</i></p>





	<i>GVJ sygjeron, rishikim të programit mësimor me qëllim rritjen e peshës në kredite të praktikës mësimore, paisjen sa më mirë të studentëve me kompetenca në përputhje me kërkesat e tregut të punës njësia bazë duhet të pasurohet me literaturë bashkëkohore, vendase dhe të huaj të pesë viteve të fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk ka reagim nga tregu i punës me sugjerime në lidhje me programin e studimit. Ekziston vetëm lista e institucioneve bashkëpunuese për zhvillimin e praktikave mësimore. Gjatë takimeve në institucion na u komunikua që janë në kontakte të vazhdueshme me institucionet bashkëpunuese për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të planifikohen e të realizohen edhe konsulta me aktorët e tregut të punës dhe një analizë e tregut të punës për këtë program studimi.</i></p> <p>Evidenca: I.31</p>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit,	<p>Në takimet me studentët, GVJ konstatoi që ata ishin shumë të interesuar për mbarëvajtjen e programit dhe shumë të kënaqur me njohuritë e përftuara në kuadër të procesit mësimor. Në takimin me NjSBC mësuam se edhe kjo njësi ishte e interesuar dhe kishte reflektuar ndaj feedback-ut, përcjellë kësaj strukture nga përfaqësuesi i studentëve. Kështu ishte vepruar edhe me hartimin e RVB nga GVB. Sipas Tabelës 22 Aktivizimi i studentëve në aktivitete e njësisë tregon për angazhimin e 2 (dy) studentëve të programit në projekte shkencore bë bashkëpunim me të tjerë, nga personeli akademik Prof.Assoc. Dr. Valbona Duri.</p>




dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	<i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Tabela Përmbledhëse, Tabela 22</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe takimet në institucion, GVJ konstaton që ekziston bashkëpunimi me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor (Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, Bashkia Gjirokastrë, DAR-Gjirokastrë, DRSH-Gjirokastrë, DRSHKP-Gjirokastrë etj) me të cilat përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesat dhe nevojat specifike locale. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: I.31; Evidenca II.36</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut UGJ përfshin në një proces të gjerë dhe gjithëpërfshirës, studentët aktual dhe Alumni për të paraqitur mendimet dhe sygjërimet e tyre të nxjerra nga eksperiencat personale. Me qëllim realizimin e objektivave të programit <u>GVJ sugjeron</u> që të planifikohen e të realizohen edhe konsulta me aktorët e tregut të punës dhe një analizë e tregut të punës për këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT




Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, sipas dokumentacionit në DVV, RVB, por edhe në takimet që GVJ zhvilloi në institucion, konstaton se format e mësimdhënies që përdoren në procesin mësimor janë metodat standarde si leksione, seminare, praktika në terren, detyrat e kursit dhe tema të diplomave. Format e lartpërmendura mbeten të hapura për përmirësime dhe pasurohen periodikisht me elementë të rinj.</p> <p>Evidenca I.9; Evidenca II.2; Evidenca II.3; Evidenca II.4</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik njih dhe respekton diversitetin e karaktereve dhe interesave individuale të studentëve dhe përshtat metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies me këto veçori. Raporti midis formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies ndryshon në varësi të natyrës së moduleve të programit, duke tentuar që në vitin e tretë të studimeve të rrisë kontaktin e drejtpërdrejtë të studentëve me objektet konkrete të profesionit të tyre të ardhshëm, nëpërmjet rritjes së peshës së praktikave mësimore dhe profesionale në raport me format e tjera të mësimdhënies/mësimnxënies. RVB; Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UGJ përkatësisht FESHSH dhe DHAGJ e mbështetin personelin akademik të programit të studimit Bachelor “Histori-Gjeografi”, në përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike nëpërmjet mobiliteteve akademike, ftesës së lektorëve të huaj, vënien në dispozicion të laboratoreve me teknologji bashkëkohore të integruar si dhe trajnimeve në kuadër të evenimenteve të posaçme si leksionet e hapura, etj. Efektive në këtë drejtim ka qenë edhe njohja dhe përdorimi i metodave online të mësimdhënies si platforma Classroom, Edumeet, Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams në kohën e pandemisë Covid-19.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: III. 1.2.3.4.5.6.7.8; Evidenca III. 12, 13, 14</p>




<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli i angazhuar në programin e studimit Bachelor “HGJ” është i mirëkualifikuar në përzgjedhjen e tij, po ashtu dhe i përditësuar në aktivitetin mësimdhënës nëpërmjet trajnimeve brenda e jashtë vendit. Shkalla e përbërjes dhe e kualifikimit të tij paraqitet si në Kriterin 1, Standarti II.2. Në këtë kontekst ai është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve si dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: III.18;</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se DHAGJ është struktura përgjegjëse për programin e studimit. Ajo përdor dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Verësimin e vazhduar të ndikimit që ato kanë në mësimdhënie e kryen duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sygjerimet e tyre.</p> <p>Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies krahas DHAGJ e kryen edhe NJSBC e cila realizon me studentët pyetësorë lidhur me qëndrimet dhe sugjerimet e studentëve për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, trajtimit të lëndës, përdorimit të metodave dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies, vlerësimit etj. Kontrollë të vazhdueshme kryhen edhe nga ana e autoriteteve drejtuese të institucionit si dhe strukturave që merren me sigurimin e cilësisë dhe performancës në nivel universiteti dhe fakulteti.</p> <p>Evidenca III.19, 20: Evidenca II.32</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë</p>	<p>Në Programin e studimit Bachelor “Histori-Gjeografi” studentët përfshihen në përmirësimin e formave e metodave të mësimdhënies nëpërmjet hartimit e realizimit të pyetsorëve nga</p> <p>1. Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK).</p>




<p>përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>2. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë (SKSHMJ).</p> <p>diskutimi me pedagogë të veçantë sipas lëndëve si dhe reagimeve të tyre në procesin e vlersimeve. Në takimin me studentët, GVJ mësoi se ata janë aktivë në drejtim të mendimdhënies për përmirësimin e formave dhe metodave si dhe pohuan që mendimet dhe sugjerimet e tyre konsiderohen nga autoritetet përgjegjëse dhe personeli akademik.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion.</p> <p>Evidenca: III.1, Evidenca 21;</p> <p>Evidenca I.31, Evidenca: I.32.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se njësia përgjegjëse, DHAGJ ofron mundësinë që format e kontrollit të të nxënit, dhënia e njohurive të jepet në mënyrë periodike dhe të larmishme nga ana e personelit akademik të kësaj njësie. Ata demostrojnë se u garantonojnë studentëve dhënien e njohurive përmes metodave të mësimdhënies bashkekohore e të larmishme duke aftësuar profesionalisht ata.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve


Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale

Kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në rregulloret e studimeve të UGJ, rregulloren e DHAGJ, programit të studimit. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të




<p>përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>vlerësimin si detyra kursi, punë në grup, provime të ndërmjetme dhe përfundimtare.</p> <p>Mënyra e vlerësimin përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Studentët njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i konsultojnë në çdo moment. Procesi i vlerësimin përgjithësisht rezulton te jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim i vazhduar gjatë gjithë vitit për elementet e përcaktuar në programin lëndor, ky përfaqëson 20-25% të vlerësimin të përgjithshëm; - Vlerësim në provim; <p>Sipas <i>nenit 39 të rregullores së studimeve në UGJ</i>, përcaktimi i raporteve mids vlerësimin të vazhduar dhe atij me provim kryhet nga personeli akademik dhe paraqitet në programin e lëndës. Frekuentimi i lëndës është i detyrueshëm në masën 80% i seminareve dhe ushtrimeve. GVJ konstaton se kjo përqindje e pjesëmarrjes së vlerësimeve për studentët është gjithëkontrolluese dhe kontribuon në përvetësimin e përmbajtjes së lëndëve përkatësisht moduleve.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: I.9, 10</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe takimeve me personelin akademik dhe studentët, GVJ mësoi që studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca II.2,3, 4: Evidenca: I.9,</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë</p>	<p>Për programin e studimit, Bachelor "Histori-Gjeografi" testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në format e mëposhtme: <i>(Neni 40: Format e kontrollit të dijeve, Rregullore e Studimeve UGJ)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Frekuentimi i detyrueshëm i seminareve dhe ushtrimeve në masën 80 %; • Testim me shkrim me gojë; • Eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, punëve në grup, prezantimeve;

<p>dhe kompetencat e fituara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesmarrja në provimet e ndërmjetme (2) dhe provimin përfundimtar; • Praktikave; • Dorëzimi dhe mbrojtja e mikrotezës; <p>Informimi dhe sqarimi i studentëve për mënyrat dhe masën e vlersimit bëhet edhe nga tutorët përkatës, që caktohen për çdo program studimi.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca II.2,3, 4: Evidenca: I.9,</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi DVV rezulton se, personeli akademik i DHAGJ-së, kryen sondazhe vlerësuese me qëllim përmirësimin e formave e metodat të mësimdhënies në mënyrë të vazhduar. Edhe gjatë takimeve që GVJ pati me studentët e këtij program studimi u konfirmua pjesmarrja e tyre në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. Jo vetëm personeli akademik por edhe NJSBC realizon me studentët pyetësorë për vlerësim. Koordinatorja institucionale gjatë takimit në institucion konfirmoi se institucioni iu refrohet vlerësimeve dhe sugjerimeve të studentëve dhe i merr ato në konsiderat për të rritur cilësinë e mësimdhënies, trajtimit të lëndës, përdorimit të metodave, etj.</p> <p>EVIDENCA III.19, 20</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe RVB GVJ konstaton se, format me të cilat UGJ kontribon në mundësimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Investimi në infrastrukturën e mësimdhënies, ku auditorët janë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies; ▪ Ngritja e laboratorëve të arkeologjisë dhe gjeografisë të cilët mundësojnë demonstrimin e materialeve të vizualizuar në funksion të mësimdhënies, realizimin e projekteve, praktikave mësimore etj. ▪ Ngritja e Labororit të SIG-ut nga aplikimin për projekte të infrastrukturës të bashkëfinancuara me AKKSHI-in; ▪ Hartimit të udhëzuesve për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies. ▪ Përfshirjen e personelit akademik në mobilitete në kuadër të programeve ERASMUS +, të BE; <p>GVJ konstaton që në programin e studimit Bachelor “Histori-Gjeogarf” format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit. Për këtë kontribuojnë posaçërisht detyrat dhe projektet individuale, në të cilat kërkohet drejtimi i orientuar nga mësimdhënësit, si dhe projektet dhe detyrat në grup ku, përpos mësimdhënësit, kontribuojnë edhe</p>





respektit të ndërsjellë mes tyre.	studentët pjestarë të grupit. Po ashtu dhe zgjedhja e temave të diplomave dhe realizimi i tyre forcon punën e pavarur të studentit dhe konfirmon vlerën e rolit udhëheqës të personelit akademik. Në realizimin e këtyre detyrave/projekteve ndërtohen edhe marrëdhënie të respektit reciprok midis tyre. RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: III.1, 12.13.14, 31, 32; Evidenca II.2, 3, 4.			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se UGJ, FESHSH, DHAGJ ka hartuar rregullore të programit te studimit bachelor në "Histori-Gjeografi", në të cilën janë parashikuar, paraqitur dhe hartuar procedura të posaçme dhe konkrete për mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesional. Proçedurat garantojnë përfshirjen e studentëve në zbatimin e tyre dhe dhënien e sygjërimeve në rast kur ka vend për përmirësime në procesin e mësimdhënies dhe të vlerësimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe takimeve me personelin akademik dhe studentët, GVJ mësoi që studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Për programin e studimit Bachelor "Histori-Gjeografi" testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në format e mëposhtme: (Neni 40: Format e kontrollit të dijeve, Rregullore e Studimeve UGJ) <ul style="list-style-type: none"> • Frekuentimi i detyrueshëm i seminareve dhe ushtrimeve në masën 80 %; • Testim me shkrim me gojë; • Eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, punëve në grup, prezantimeve; • Pjesmarrja në provimet e ndërmjetme (2) dhe provimin përfundimtar; • Praktikave;




	<ul style="list-style-type: none"> • Dorëzimi dhe mbrojtja e mikrotezës; <p>Informimi dhe sqarimi i studentëve për mënyrat dhe masën e vlersimit bëhet edhe nga tutorët përkatës, që caktohen për çdo program studimi.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion; Evidenca II. 2, 3, 4; Evidenca: I.9, Evidenca II.2,3, 4; Evidenca: I.9,</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlersimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konstatoi që, UGJ vë në zbatim projektin CLEANSCORE të financuar nga AADF për testimin dhe vlerësimin elektronik. Kjo u konfirmua edhe nga personeli akademik që ka aplikuar sistemin CLEANSCORE gjatë vizitës në institucion.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca III.23</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri zbatohet detyrimi i përcaktuar në rregulloret përkatëse. Vlerësimi përfundimtar bëhet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga departamenti dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: I.9, neni 39 dhe neni 44</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në takimin që GVJ zhvilloi me sekretarinë mësimore mësoi që vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për çdo rast i bëhet e ditur studentit duke i dhënë shpjegime për përgjigjet dhe duke e bindur atë që vlersimi është i drejtë. Gjatë diskutimeve të tilla pedagogu i tregon studentit çfarë është bërë gabim dhe si duhej bërë që përgjigja të ishte e saktë. Në këtë proces studenti ndihmohet që të përmirësohet në të ardhmen.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: I.2 neni 90; Evidenca I.9 neni 46</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në të gjitha testet dhe mënyrat e vlersimit pedagogu (në rastin e detyrave të kursit, punëve laboratorike, realcioneve të praktikës profesionale) apo komisioni (në rastin e provimeve të lëndëve, mbrojtjes së mikrotezës) shqyrton përgjigjet edhe me përgjegjësinë për të evituar plagjiaturën përkatësisht kopjimin. Në rast të konstatimit studenti vlerësohet negativisht dhe është i detyruar të përsërisë punimin përkatësisht provimin.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: I.2; I.9; I.20; III. 26</p>




<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulët kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga platforma <i>Pitagora</i>, ose edhe me komunikim verbal dhe individual nga ana e pedagogut. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigohet nga komisioni dhe brenda 5 ditëve. Studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit <i>Pitagora</i>. Pas marrjes së vlerësimit pedagogu i lëndës, me kërkesën e studentit, bën shpjegimet lidhur me vlerësimin. Gjate vitit pedagogët janë të lirë të kombinojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese, të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, prezantime ne grup ose individuale, etj. Çdo student mund të hyjë dhe të informohet më parë me statusin për notat, detyra kursi, pagesat, data provimesh etj në hapësirën <i>on-line</i> për studentët në <i>Pitagora</i>. https://uogj.pitagora.rash.al/login</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: III. 30, 31,32</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në takimin me studentet, GVJ konstatoi që ata njohin te drejtën e tyre për ankimim. Pas shpalljes se rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Pas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare. Mbas kësaj faze, sërish studenti ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: I. 2,9, 20</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se UGJ, FESHSH, DHAGJ siguron që studentët të informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të</i></p>





	<i>parashikuara në syllabuset e lëndëve. Testimi, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, rishikimi i vlerësimit dhe ankimimet realizohen sipas procedurave të përcaktuara në Rregullorën e e Studimeve të UGJ-së. Përmbajtja e zbatimi i kësaj rregullore siguron shmangjen e abuzimit dhe rrit transparencën në funksion të sigurimit të cilësisë së zhvillimit të programit të studimit bachelor në “Histori-Gjeografi”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Nga shyrtimi i dokumentacionit shoqërues dhe RVB programi i studimit garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësi profesionale. Ai është hartuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa” në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41”, datë 24.01.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, grupohen në kategoritë e mëposhtme:</p> <p>Programi reflekton shpërndarje të balancuar të njohurive si në lëmin e historisë dhe ashtu edhe atë të gjeografisë. Në përgjithësi shpërndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese është kryer në respektim të ngarkesë në kredite. GVJ konsideron se pesha në kredite e punës praktike është shumë e ulët. Duhet theksuar se brenda lëndëve ka edhe punë laboratorike si dhe vizita me karakter profesional, gjë që e rrit efektin e praktikës.</p> <p><i>GVJ sygjeron rishikim të programit mësimor, për të rritur peshën në kredite të praktikës mësimore.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton	Në programin mësimor të programit të studimit Bachelor “Histori-Gjeografi” garantohej zhvillimi i aftësive të veçanta





<p>zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit pasi vetë shprehitë lëndore të fushës histori-gjeografi janë të pasura me aftësi komunikuese, ndërvepruese ku më të shprehura janë në lëndët si Baza SIG-u, praktikat në terren, hyrje në gjeografi humane, sitet arkeologjike etj.</p> <p>RVB; Evidenca: Aneks Tabela Përmbledhëse.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmyllëse.</p>	<p>Qysh në fillim të zhvillimit të programit të lëndës, studenti njihet me përmbajtjen e syllabusit të hartuar nga titullari i lëndës. Në realizim të programit mësimor, për çdo lëndë të veçantë, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në testet dhe vlersimet përkatëse, në diskutimet për to si dhe duke tërhequr vlerësimet e të diplomuarve e të punësuarve në këtë PS.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: II. 2, 3, 4; Evidenca III. 11</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri shërben shqyrtimi i aktivitetit që zhvillohet në laboratorët e programit. GVJ konstatoi që laboratorët e vënë në dispozicion të këtij PS ishin të paisur me programet më të fundit që përdoren për GIS-in e aplikuar. Përdorimi i tyre u jep mundësi studentëve të zhvillojnë e konkretizojnë njohuritë e marra në të gjitha lëndët që karakterizojnë programin. Duke konsultuar planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton që zhvillimi i detyrave apo projekteve kërkon punën në grup, e cila mbështetet nga personeli akademik i ngarkuar me zhvillimin e këtij programi si dhe realizohet nga studentët e tij. Në takimin me studentët ata u shprehën të arrirë me funksionimin e punës në grup si dhe evidentuan kontributin e pedagogëve në realizimin me sukses të saj.</p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidenca II. 2, 3, 4</p>




mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.									
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga dosja e DVV rezulton se personeli akademik efektiv dhe me kontratë që shërben në programin e studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, zhvillon leksione të hapura, workshope, me kolege brenda dhe ekspertë të ftuar të jashtëm, ku si objekt i tyre janë të rejat e shkencës së gjeografisë dhe historisë dhe përdorimi i teknologjisë në funksion të tyre. Këto aktivitete i gjejmë të pasqyruara, të dokumentuara edhe në raportet vjetore të përgatitura nga DHAGJ, planin e veprimtarive vjetore akademike dhe veprimtarive kërkimore shkencore. RVB; Evidenca III. 34, 35, 33								
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se UGJ, FESHSH, DHAGJ garanton thellimin e njohurive dhe aftësimin profesional të studentëve nëpërmjet një shpërndarje të balancuar të njohurive si në lëmin e historisë dhe ashtu edhe atë të gjeografisë. Në përgjithësi shpërndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese është kryer në respektim të ngarkesë në kredite. GVJ konsideron se pesha në kredite e punës praktike është shumë e ulët. Duhet theksuar se brenda lëndëve ka edhe punë laboratorike si dhe vizita me karakter profesional, gjë që e rrit efektin e praktikës. Por, në të ardhmen GVJ sygjeron rishikim të programit mësimor, për të rritur peshën në kredite të praktikës mësimore.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet	Nga shqyrtimi i dokumentacionit por edhe RVB konstatohet se UGJ harton rregullore të studimeve. Në rregulloren e programit të studimit në Bachelor në “Histori-Gjeografi” përcaktohet qartë pragu i notës mesatare, i cili është 8 dhe i që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. Provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës është i parshikuar në në Kreun VIII “Diplomimi” të Rregullores




<p>pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>së Studimeve në UGJ, Rregullores së UGJ, Kreun VII “Diplomimi” të Rregullores së FESHSH, dhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”.</p> <p>RVB; Evidenca I.2, 9,10, 20, 21</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe RVB-së GVJ konstaton se DHAGJ është përgjegjës për programin e studimit dhe personeli akademik vënë në dispozicion të studentëve materiale të nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Këto udhëzime janë të pasqyruara në Rregulloren e studimeve në UGJ dhe shtojcave nga 1-6 të kësaj rregulloreje, Rregullores së Programit të Studimit dhe Programit të provimit të përgjithshëm përfundimtar. Në këtë të fundit pasqyrohen të gjithë konceptet bazë në të cilat studentët duhet të fokusohen në përgatitjen e tyre për provim, dhe literatura bazë. GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin e realizuar me studentët e këtij program studimi gjatë vizitës në institucion.</p> <p>RVB; Evidenca I. 9,10; II. 17, 19</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së studimeve në UGJ, respektivisht Neni 62 pika 3, Neni 64 konstatohet se testimi i njohurive për të gjithë periudhën e studimit 3-vjeçar përfshin të gjitha lëndët dhe modulet bazuar në peshën specifike të tyre. Gjithashtu kjo pasyrohet edhe në Programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar të miratuar nga DHAGJ me propozim nga njësia bazë që administron programin e studimit. Mbështetur në përmbajtjen e këtij programi komisioni harton tezën e provimit përfundimtar, e cila miratohet nga drejtuesi i njësisë bazë.</p> <p>RVB; Evidenca I. 9,10; II. 17, 19; Evidenca III. 32</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e</p>	<p>Në DVV dhe RVB konstatohet se personeli akademik i DHAGJ, në fillim të vitit të tretë të studimeve Bachelor përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës. Udhëheqësi i temës së diplomës harton programin e punës për studentin. Në këtë program parashikohen afatet kohore për realizimin e punës sipas etapave, grafiku i konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe aprovon lejen për mbrojtjen e punimit duke firmosur punimin e plotë të diplomës. Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve</p>




<p>rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>në UGJ. GVJ e konfirmojn kryerjen e këtij procesi edhe gjatë takimit me studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion.</p> <p>RVB; Evidenca I. 9; II. 17, 18; Evidenca III. 32; Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>DHAGJ është përgjegjës për zhvillimin e programin e studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi" drejton dhe administron realizimin e praktikës në terren, që është e pjesë e programit mësimor. Gjatë zhvillimit të praktikës studentë realizojnë testime, pyetësor dhe intervista, për qëllime studimi, në mjediset e planifikuara në itinerarin e praktikës, nën mbikëqyrjen e personelit akademik dhe në përputhje me objektivin që ka fusha e studimit "Histori-Gjeografi". Drejtuesja e njësive bazë në takimin që zhvillon me studentët në fillim të vitit akademik u komunikon studentëve informacionin mbi kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe mbrojtjes. Gjithashtu, DHAGJ ofron infrastrukturën mësimore (laboratorët e ARCGIS) për testime edhe në kuadër të përgatitjes së studentit për realizimin e temës së diplomës. Gjatë takimit me studentët, GVJ-së iu konfirmua realizimi i anketave dhe pyetësorëve për qëllime të realizimit të detyrave, projekteve dhe temave të diplomës.</p> <p>RVB; Evidenca I. 9, 35, 36; II. 17, 18; Evidenca III. 12, 13, 14; Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së studimeve në UGJ, Neni 62 pika 5, 6, Neni 64 pika 3, 4 konstatohet se, studenti vlerësohet me notë në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së punimit të diplomës. Pas nënshkrimit nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës rezultati pasqyrohet në procesverbalin përkatës. GVJ e konfirmoi këtë edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të UGJ.</p> <p>RVB; Evidenca I. 9; II. 19; Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton se UGJ në përfundim të studimeve, i pajis studentët e programit të studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi" me diplomë, listën e notave dhe suplementin e diplomës. Ky proces realizohet nga sekretaria mësimore e FESHSH, e cila pas depozitimit të procesverbaleve të vlerësimit realizon procedurat e pajisjes së studentit me dokumentacionin e diplomimit, duke vënë në dispozicion kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar. Gjithashtu konstatohet se, suplementi i Diplomës për programin e studimit Bachelor në "Histori-</p>




programit të studimit të zhvilluar.	Gjeografi” është në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR. RVB; Evidenca I. 1, 9, 2; II. 1, 20; Vizita në institucion			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UGJ në zbatim të Nenin 101 të Ligjit të arsimit të lartë, Statutin e UGJ si dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore ruan, administron dokumentacionin e studentit në: <ul style="list-style-type: none"> ▪ regjistrin themeltar të studentëve; ▪ regjistrin e arritjeve akademike; ▪ regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucioni kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. RVB; Evidenca I. 1, 9; III. 36, 37; Vizita në institucion			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se DHAGJ ka rregullore të programit të studimit në “Bachelor” në Histori-Gjeografi në të cilën përcaktohen qartë pragu i notës mesatare, i cili është 8 dhe i që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. Proçedurat e provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës janë të parshikuar në rregulloren e studimeve të UGJ-së dhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”. Peroneli akademik nëpërmjet zbatimit të rregulloreve garantojnë ndihmesë dhe asistim të studentëve për realizimin e detyrave, matjeve për qëllime të zhvillimit të projekteve dhe temave të diplomës. Të gjitha këto procedura janë të ruajtura dhe administohen nga njësia përgjegjëse për PS.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**


Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

GVJ nëpërmjet të dhënave të ofruara nga institucioni konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Bachelor” në Histori - Gjeografi përmbush kërkesat ligjore në fuqi, përsa i përket nivelit të kualifikimit akademik, drejtimit dhe angazhimit në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit. Tabelat 6.1-6.33 evidentojnë numrin e lektorëve sipas titujve dhe gradave akademike për tre vite akademike si më poshtë vijon:

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	4	4	3	4	4	4
Prof.As.Dr	4	1	4	-	3	-
Dr/PhD	2	1	2	1	2	1
Msc	2	1	3	1	2	2
Në total	12	7	12	6	11	7

Për vitin akademik 2020-2021, 68% e personeli akademik i përket kategorisë “Profesor” dhe pjesa tjetër kategorisë “Lektor” dhe “Asistent Lektor”; ndërkohë për dy vitet e tjera në vijim kjo peshë është e njëjtë në 61%. Anëtarët e personelit akademik të kategorisë “Profesor”, janë titullarë të lëndëve ose moduleve (vëzhguar në syllabuset e lëndëve) dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Ata asistohen, nga personeli akademik i kategorive të tjera nëse është e nevojshme. Institucioni i kushton rëndësi cilësisë së kualifikimit të personelit që në momentin e punësimit të tij/saj, për të qënë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e lëndëve/moduleve. Mbeshtetur dhe tabelat 12.1-12.3 aneks tabelat përmbledhese, në bazë të orëve të realizuara nga personeli akademik PAE dhe PAK, për cdo vit akademik, ky kriter është I përmbushur.

	<p>Evidenca IV.1. Neni 4, Neni 5, Neni 6, Evidenca III.18, Evidenca IV.2, Evidenca IV.3, ANEKS- TABELAT PËRMBLEDHËSE –Tabelat 12</p> <p>GVJ konstaton se personeli akademik kualifikohet në vazhdimësi, duke u përfshirë në aktivitete shkencore/profesionale dhe kryer publikime. Veprimtaria e tyre shkencore dëshmohe në Raportet Vjetore. Evidenca I.15., Evidenca I.16., Evidenca I.17, Evidenca I.18. Vizita në institucion dhe takimet me stafin akademik dhe studentet përforcojnë konstatimin e mësipërm.</p>																				
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, ANEKS- TABELAT PËRMBLEDHËSE- Tabelat 12.1-12.3, mbulimi i ngarkesës mësimore për tre vite akademike rezulton si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="576 786 1369 999"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>2029</td> <td>1653</td> <td>376</td> <td>81.5% / 18.5 %</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>2029</td> <td>1668</td> <td>361</td> <td>82% / 18%</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>2029</td> <td>1728</td> <td>301</td> <td>85% / 15%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga sa më sipër rezulton që për 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik efektiv (PAE), sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.</p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2020-2021	2029	1653	376	81.5% / 18.5 %	2021-2022	2029	1668	361	82% / 18%	2022-2023	2029	1728	301	85% / 15%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2020-2021	2029	1653	376	81.5% / 18.5 %																	
2021-2022	2029	1668	361	82% / 18%																	
2022-2023	2029	1728	301	85% / 15%																	
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të UGJ, GVJ konstaton se ky institucion dëshmon nëpërmjet kontratave të rregullta të punësimit dhe nga pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit “Bachelor” në “Histori-Gjeografi” për të gjithë periudhën kohore të përfshirë nën akreditim. Gjatë vizitës në institucion në zyrën e burimeve njerëzore u njoh konkretisht me kontratat e presoneli akademik efektive dhe me kontratatë si edhe në degën e ekonomike të tij.</p> <p>Evidenca IV.8, Vizita në institucion, Takimi në zyrën e Burimeve njerëzore dhe degën e financës.</p>																				
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë</p>	<p>GVJ konfirmon se UGJ harton dhe ndjek procedura për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik, në mbështetje të akteve ligjore, shprehur në evidencat si: Evidenca I.1, Evidenca I.2, Evidenca IV.1, Evidenca II.34, Evidenca II.35.</p> <p>Procedurat e rekrutimit janë të mirëpërcaktuara nga DHAGJ, duke filluar me përcaktimin e kritereve të përgjithshme dhe ato</p>																				




<p>përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>specifike, përcjelljen e kërkesës për punësim dhe miratimin e saj nga Rektori dhe më tej kalohet në procesin e publikimit në Buletin e Prokurimeve Publike dhe në faqen zyrtare online të universitetit. Komisionet “ad-hoc” të ngritura nga Rektori i UGJ ose Dekani i FESHSH bejnë vlerësimin e kandidaturave, ndërsa struktura menaxhuese e burimeve njerëzore mbështet procedurat e konkurimit në zhvillimin e tyre. Vizita në institucion bëri të mundur njohjen e rasteve të rekrutimit të personelit akademik të kategorive PAE dhe PAK.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se 1 (një) personel ndihmës akademik është pjesë e DHAGJ, i cili është i angazhuar në ndihmë të realizimit të orëve laboratorike dhe mirëmbajtjes së tyre dhe mjediseve të tjera mësimore. Institucioni ka të përcaktuar në rregullore mënyrën e rekrutimit të stafit ndihmës akademik, detyrimet dhe përgjegjësitë e punës së tij, të dëshmuara në evidencat në vijim. UGJ siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm në ndihme të realizimit të orëve praktike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore.</p> <p>Evidenca I.1, Evidenca I.2, Evidenca I.21, Evidenca IV.9, ANEKS- TABELAT PËRMBLEDHËSE –Tabelat 1-2, Evidenca I.28., Vizita në institucion.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>UGJ mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Histori-Gjeografi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Evidenca III.37, Evidenca IV.11. Ky proces kryhet nga Sektori i Shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari-protokoll, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike-Administrative (DSHNA) i cili kryen veprimtarinë e tij në bazë të statutit të UGJ dhe rregullores përkatëse. Evidenca I.1, Evidenca IV.9. Gjithashtu të dhëna për veprimtarinë shkencore dhe angazhimet profesionale të personelit akademik ruhen dhe administrohen dhe nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Veprimtaria e këtij sektori bazohet në Rregulloren e DSHNA-A Evidenca IV.9.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se DHAGJ ruan të dhëna mbi angazhimin e kohës vjetore dhe për çdo semestër të punës së personelit akademik dhe ndihmës akademik. Evidenca I.20, Evidenca I.21, Evidenca II.10, Evidenca II.11, Evidenca II.12, Evidenca II.13, Evidenca III.24, Evidenca IV.10, Vizita në institucion.</p>

<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Eqrem Çabej” dëshmon se ka marrëveshje bashkëpunimi, me insitucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe institucione të tjera lokale dhe agjenici kombëtare, të cilat i vë në funksion të programit mësimor. Universiteti qysh nga viti 1993 ka nënshkruar 126 marrëveshje bashkëpunimi duke filluar nga kohëzgjatje të pacaktuar deri në ato me kohëzgjatje 6 vjecare. Ndërsa pas vitit 2020 numri i marrëveshjeve të lidhura është 31. Evidenca I.31. Këto bashkëpunime i vijnë në ndihmë departamentit për realizimet e diplomave të studentëve si te programit te studimit ashtu dhe veprimtarive të tjera duke përjashtuar udhëheqjen e studentëve në praktikën profesionale. Kjo pasi programi “Bachelor” në “Histori-Gjeografi” nuk e ka të përfshirë praktikën e detyruar profesionale në studimet 3-vjeçare. ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE</p> <p>Gjithashtu DHAGJ, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës. Bazuar në dokumentacionin bashkëshoqërues dhe takimit në institucion (me personelin akademik dhe studentët), GVJ konstaton se studentët realizojnë punimin e diplomës pasi drafti i saj kalon në procedura miratimi, ndërsa udhëheqësit shkencore udhëheqin dhe monitorojnë realizimin e saj. Bashkëpunimi me insitucione të tjera shihet si frytdhënës nga studentët dhe si ndikues në rritjen e aftësive profesionale dhe akademike.</p> <p>Vizita në institucion, Evidenca II.18; Evidenca I.9. dhe Evidenca II.19 nuk shprehin marrëdhënie bashkëpunimi ndërinstytucional.</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Dokumentacioni bashkëshoqërues ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE dëshmon se programi I studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, nuk e ka përfshirë praktikën e detyruar profesionale në studimet 3 vjeçare. Por studentët ndjekin me interes praktikat në terren dhe vlerësojnë seriozitetin e personelit akademik në realizimin me korrektësi të kësaj detyre.</p> <p>Vizita në institucion</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e</i></p>





	<p><i>duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, përsa i përket nivelit të kualifikimit akademik, drejtimit dhe angazhimit në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit. Personeli akademik kualifikohet në vazhdimësi, duke u përfshirë në aktivitete shkencore/profesionale dhe kryer publikime. Institucion dëshmon nëpërmjet kontratave të rregullta të punësimit dhe procedura të qarta të rekrutimit. Staf i ndihmës akademik mbështet punën në DHAGJ; Diplomimi dhe procedurat e tij janë të mirë përcaktuara.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Dokumentacioni bashkëshoqërues dhe vizita në institucion konfirmojnë se Universiteti “Eqrem Cabej”, siguron kushte të përshtatshme fizike për zhvillimin e veprimtarisë mësimore (si ato higjieno-sanitare, të potencializimit të ndricimit, mbrojtjes ndaj zjarrit, ngrohjes dhe ftohjes, lagështirës). DGJAGJ e zhvillon procesin mesimor në Godinën B e cila ka një sipërfaqe prej 1937 m². Kjo godinë ka kapacitet për 951 vende për zhvillimin e lekioneve dhe seminareve. Evidenca IV.12, Evidenca IV.13, Evidenca IV.15, Evidenca IV.14, Evidenca IV.4, Evidenca IV.5. Ndërsa raporti i MAS mbi “Verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2023-2024”, tregon se Uiversiteti “Eqrem Cabej” ofron një normativë të pritshme mesatare prej 2.5 m²/student. Evidenca IV.6. Në ndihmë të zhvillimit të veprimtarisë mësimore si për leksionet dhe seminarat e programit të studimit, shërbejnë dhe mjediset e bibliotekës dhe dy labororet (laboratoti i Arkeologjisë dhe ai i Gjeografisë) të cilat gjenden po në Godinën B.</p> <p>Evidenca III.13, Evidenca III.14, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 16, Evidenca III.12</p>


<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni ka pajisur mjediset mësimore me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, me qëllim që studentët dhe personeli akademik të maksimalizojnë përdorimin e tyre në funksion të zhvillimit cilësor të procesit mësimor të mësimdhënies dhe nxënies. Gjatë vizitës në institucion, në Godinën B, ku zhvillojnë procesin mësimor studentët e programit të studimit “Bachelor” në Histori-Gjeografi, GVJ konstaton se infrastruktura laborotike (pajisje të laboratorit të arkeologjisë dhe gjeografisë, GIS dhe hartat e ndryshme), didaktike ishte e pranishme dhe të aksesueshme në çdo moment të nevojshëm si për studentet ashtu dhe për personelin akademik, në ndihmë të përgatitjes dhe të realizimit të procesit mësimor teorik e praktik. GVJ kishte mundësi t’i vëzhgonte konkretisht.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ pa nga afër mjediset, mjetet informatike e teknike të cilat aksesohen në kushte të barabarta për të gjithë studentët, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga procesi mësimor.</p> <p>Evidenca III.12, Evidenca III.13, Evidenca III.14, Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vëzhgoi mjediset ku zhvillohet procesi mësimor për PS bch në “HGJ”, në veçanti u ndal në Laboratorin e GIS-it ku pa nga afër aparaturat dhe mjetet e nevojshme, të përshtatshme për plotësimin e objektivave lëndorë, në funksion të aftësimin teorik dhe praktik, si dhe të objektivave formuese të programit të studimit Bachelor në Histori-Gjeografi. Krahas instrumenteve teknik, teknologjike në dispozicion shërbenin edhe hartat historike/gjeografike janë vënë në shërbim të përmbushjes së objektivave mësimore dhe specifikave të lëndëve.</p> <p>Evidenca III.12, Evidenca III.13, Evidenca III.14, Evidenca III.25, Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratori i SIG/GIS është një laborator i ngritur së fundmi në DHAGJ, si rrjedhojë e një bashkëfinancimi me AKSHI-in të një projekt të miratuar nga MAS. Teknologjia GIS është një teknologji e avancuar në studimet gjeografike dhe historiko-gjeografike, dhe mjaft e rëndësishme në analizat gjeohapësinore, të cilat në vetvete përmbajnë rezultate të nxënies së njohurive gjeografike dhe historiko-gjeografike në modulet dhe lëndët e programit të studimit. Dokumentacioni shoqërues dhe vizita në institucion konfirmuan plotësimin e këtij kriteri.</p>




	Evidenca III.14, Vizita në institucion			
Konkluzione	<i>GVJ nëpërmjet dokumentacionit bashkëshoqërues, evidentimeve gjatë vizitës në institucion konstaton përmbushjen plotësisht të standartit. Mjediset mësimore, laboratorët lëndorë dhe teknologjikë etj, mundësojnë realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Bachelor në Histori-Gjeografi dhe procesit të nxënies praktike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, në takimet me personelin akademik dhe studentët, u konstatua një marrëdhënie bashkepunuese pozitive në drejtim të garantimit të marrjes së dijeve dhe njohurive të nevojshme nëpërmjet literaturës bazë (ne gjuhën shqipe) dhe ndihmëse (ne gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj). Ajo ofrohet në formë fizike dhe/ose online. Një rol mbështetës në këtë drejtim luan biblioteka e universitetit me fondet e tyre fizike dhe digjitale. Literatura bazë dhe ajo ndihmëse është e evidente në syllabuset e lëndëve dhe përcaktimi i tyre kalon në procedura miratimi nga ana e DHAGJ, dëshmuar në dokumentacionin institucional. Vizita në institucion, Evidenca I.20, Evidenca I.9, Evidenca I.21, Evidenca I.10, Evidenca II.29, Evidenca II.30.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	DHAGJ, përpara miratimit të buxhetit vjetor institucional, paraqet propozimin e tij për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. Vihet re që propozimet janë kryesisht tekste/libra të gjeografisë fizike dhe grup hartash dhe atlase. <i>GVJ thekson se këto propozime duhet të jenë dhe në sferën e teksteve/librave të historisë, me qëllim përditësimin e literaturës bazë dhe ndihmëse me botime të fundit.</i> ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Evidenca IV.23.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke	Studentët mund të shfrytëzojnë në mënyrë të barabartë bibliotekën mësimore, pasi janë regjistruar dhe janë pajisur me një kartelë personale. Mjediset e bibliotekës ndodhen në Godinën C të UGJ. Sallat e saj janë të pajisura me infrastrukturë mbështetëse dhe

<p>garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>lehtësuese për studentët. Studentët mund të shfrytëzojnë dhe bibliotekën online. Fondi i librave paraqitet i përshtatshëm në fushën e programit të studimit “Bachelor” në Histori-Gjeografi.</p> <p>Evidenca IV.24, Evidenca IV.25, Evidenca IV.26, Evidenca IV.23, Evidenca IV.27, Evidenca III.25, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e universitetit mbështet procesin mësimor dhe formimin akademik, profesional, të studentëve dhe personelit akademik, duke vënë në dispozicion të tyre një fond të pasur librash në gjuhë të huaj dhe në gjuhën shqipe. Në Bibliotekën Akademike gjenden një fond prej 255 titujsh në fushën e gjeografisë, 690 titujsh në fushën e historisë dhe 122 titujsh në fushën e etnologjisë të cilat janë në shërbim të programit të studimit “Bachelor” në Histori-Gjeografi. Gjithashtu literatura ndihmëse dhe ajo bazë mund të shfrytëzohet jashtë dhe në mjediset e bibliotekës e cila gjendet në Godinën C të universitetit. Po kështu bibliotekat online janë mjaft suportive ndaj studenteve sidomos në mjediset jashte fakultetit. Gjithashtu studentët mund të përdorin fondin me tituj të ndryshëm të dedikuar njohurive historike dhe gjeografike nga vetë biblioteka e DHAGJ Evidenca III.25</p> <p>Takimi me studentet, RVB, Vizita në institucion, Evidenca IV.23, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 17</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se funksionimi i bibliotekës kundrejt shërbimeve ndaj studentëve dhe personelit akademik realizohet në kushte të barabarta dhe ajo ofron shërbimin e saj pa pagesë. ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE- Tabela 17, Evidenca IV.23, Evidenca III.25. Studentët dhe personeli akademik kanë aksesin e tyre në shërbimin <i>on-line</i> të Bibliotekës “U-Library”, [https://ulibrary.rash.al/], [https://uogj.edu.al/biblioteka-online/] dhe JSTOR. U evidentua se abonimi i Bibliotekës në revista shkencore ndërkombëtare <i>on-line</i>, ka krijuar mundësi për studentët/pedagogët në qasjet ndërkombëtare akademike, duke mundësuar shfrytëzimin e literaturës në gjuhë të huaj. Evidenca IV.25, Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa</p>	<p>GVJ evidenton se biblioteka u ka mundësuar studentëve dhe personelit akademik që nëpërmjet programeve kompjuterike të bëjnë të mundur aksesimin dhe shfrytëzimin e fondit të bibliotekës, përmendim këtu programin COBISS (aksesim në 1900 tituj), aksesimin elektronik në U-Library, JSTOR dhe International Association Universities. Ajo ka 3 salla dhe 53 vende</p>




kufizim për të gjithë studentët.	studimi. Evidenca IV.23, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Mjediset e bibliotekës qëndrojnë të hapura gjatë ditëve të javës (nga e hëna në të premte), në orarin 8:00-19:00, duke u krijuar mundësi studentëve dhe personelit akademik aksesimin e literatures së nevojshme, në varësi të zhvillimit të procesit mësimor, por dhe në përgjigje të nevojave të lexuesve. GVJ konstatoi afishimin e orarit në mjediset e institucionit duke bërë të mundur orientimin e lexuesve të saj mbi aksesimin dhe mundësitë e hyrjes në Bibliotekë. Vizita në institucion
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga shqyrtimi i dy evidencave Evidencat IV.23, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 17 u njohëm me pasqyrën e gjendjes së fondin e bibliotekës dhe të dhënat e plota mbi platformat on-line/ strukturat e teknologjisë së infomacionit për bibliotekat. Fondi i titujve pasurohet herëpashere nëpërmjet dy formave: nga blerjet/ abonimet dhe dhurimet. Ato i kane shërbyer dhe personelit akademik në veprimtaritë e tyre akademike dhe kualifikimet profesionale. Këto fakte GVJ i pa konkretisht gjatë vizitës në bibliotekën e UGJ-së, më konkretisht vëzhgimi u përqëndrua në fondin e dedikuar për PS BCH në "HGJ", kartelat e studentëve e personelit akademik të këtij programi, që shfrytëzonin fondin dhe mjediset e saj të cilat dëshmonin për tituj në funksion të programit dhe shkallë të lartë shfrytëzimi nga studentët dhe personeli akademik. Vizita në institucion
Konkluzione	<i>Programi i studimit përmban literaturën e nevojshme në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme). Ai garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme nëpërmjet literaturës bazë dhe ndihmëse duke u ofruar në formë fizike dhe/ose online.</i>






	<p><i>Vihet re propozime më të shumta kryesisht për tekste/libra të gjeografisë fizike dhe grup hartash dhe atlase, por ato duhet të jenë të tilla dhe në sferën e teksteve/librave të historisë, me qëllim përditësimin dhe mbështetjen e mësimdhënies. Biblioteka shfrytëzohet në mënyrë të barabartë për të gjithë studentet dhe aksesohet lehtësisht. Fondi i saj mbështet programin e studimit janë në shërbim të programit të studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur, GVJ evidenton se UGJ disponon sistem të menaxhimit, të organizuar në disa pjesë, nëpërmjet të cilit administrojnë të gjitha informacionet që lidhen me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Ky menaxhim nis qysh me systemin U-Albania i cili është pjesë e rrjetit akademik shqiptar RASH dhe QSHA. Evidenca IV.29. Ndërsa sistemi elektronik Pitagora është një sistem tjetër në funksion të studentëve, pedagogëve, sekretarisë, administratorëve, Evidenca I.1, Evidenca III.36, Evidenca III.30, si dhe më herët ka funksionuar sistemi elektronik i automatizimit të proceseve të Sekretarisë Mësimore dhe shërbimeve <i>on-line</i> për studentët, Sistemi Esse3. Evidenca III.28., Evidenca III.29, RVB</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të</p>	<p>GVJ konstaton se DHAGJ ruan dhe menaxhon dokumentacionin mbi aktivitetin kërkimor-shkencor, dhe të procesit mësimor të njësisë së programit të studimit Bachelor në Histori-Gjeografi, ndërkohë bashkë me UGJ menaxhojnë dokumentacionin e personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. UGJ e menaxhon informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin nëpërmjet dy sektorëve:</p> <p>1. Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike-Administrative nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sektorit Protokoll;</p>


<p>angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>2. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve më Jashtë, i cili administron bazën e të dhënave të kërkimit shkencor, të personelit akademik;</p> <p>Evidenca IV.9, Evidenca I.1, Evidenca I.20, ANEKSTABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 4, Evidenca II.11, Evidenca II.12, Evidenca II.13, Evidenca II.2, Evidenca II.3, Evidenca II.4, Takimet në institucion, RVB</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UGJ-ja nëpërmjet sistemit elektronik Pitagora krijon mundësinë, të gjithë personelit dhe studentëve të programit të studimit të kenë akses të dedikuar dhe konfidencial në informacione dhe dokumente. Personeli akademik, studentët dhe ai ndihmës akademik aksesojnë informacionin si individual ashtu dhe për lëndët mësimore, orarin, vlerësimet, njoftimet e ndryshme etj. Stafi ndihmës akademik dhe ai administrativ mbështet me këtë menaxhim, duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e gjithësecilit. Evidenca IV.30, Evidenca III.31, Evidenca III.32.</p> <p>Një mënyrë e dytë e aksesimit të informacionit të përditësuar mbi veprimtarinë e DHAGJ dhe gjithë universitetit është dhe faqja zyrtare online e UGJ. Evidenca IV.31. https://uogj.edu.al/Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore (uogj.edu.al)</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>UGJ ka zgjedhur të përdorë paketën e platformës Microsoft Office 365, Microsoft Teams për të mundësuar komunikimin interaktiv midis personelit akademik dhe studentëve. Ata shkëmbejnë informacione të nevojshme në kohë reale në dobi të procesit mësimor dhe edukativ. Për aksesimin e platformës janë hartuar manuallet e përdorimit të platformës OFFICE 365 dhe TEAMS për personelin akademik dhe studentët.</p> <p>Evidenca III.8, Evidenca III.9, Evidenca III.10, RVB</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Fakti që platformat e përzgjedhura (evidentuar më sipër) për përdorim nga UGJ mund të aksesohen në kohë reale, krijon mundësi që palët vepruese të gjenerojnë të dhëna evidente dhe të monitorueshme në cdo kohë. Organet drejtuese lehtësisht mundësojnë raportime mbi aktivitetin akademik, administrativ dhe ecurinë e procesit mësimor, përfshirë dhe veprimtaritë akademike dhe menaxhuese të vlerësimit të studenteve. Evidenca III.8, Evidenca III.9, Evidenca III.10. Në linkun në vijim studentët mund të monitorojnë nevojat e tyre nëpërmjet faqes online të UGJ në zërin: “Hapësira Online për Studentët Pitagora”, Hapesira Online për Studentet Pitagora (uogj.edu.al)</p>




<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ hulumtoi faqen zyrtare online të UGJ dhe konfirmon se informacioni mundësohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën e huaj angleze. Po kështu informacion në të dy gjuhët, shfaqet dhe për DHAGJ publikuar në faqen zyrtare online të UGJ.</p> <p>Evidenca I.1, http://uogj.edu.al/; Faculty of Education and Social Sciences (uogj.edu.al)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UGJ ka disa platforma elektronike si psh: U-Albania, Pitagora, Microsoft Teams, dhe kanal komunikues të faqes zyrtare ëeb të UGJ të cilat bëjnë të mundur informimin, administrimin, monitorimin e veprimtarisë mësimore, praktikave administrative, financiare, shkencore në dobi të programit të studimit. Dokumentacionet bashkëshoqëruese mbështesin këtë konstatim.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstatin se UGJ harton një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare, të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit, përfshirë në të dhe programin e studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”. Vihet re një bashkeverpim midis hallkave të institucionit me qëllim vlerësimin, realizimin e maksimalizimin e përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të DHAGJ. Hartimi i raportit financiar bazohet në Statutin e UGJ. Raportet janë vjetore dhe parashetrojnë të dhënat financiare në vazhdimësi.</p> <p>Evidenca I.1, Evidenca IV.16, Evidenca IV.18, Evidenca IV.19, Evidenca IV.20, Evidenca I.3.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për</p>	<p><i>Neni 99</i> i statutit të UGJ, përcakton qartësisht burimet e financimit të UGJ (buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimin; të ardhurat e krijuara nga të mësuarit gjatë gjithë jetës; të ardhurat</p>

<p>programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>nga shërbimet e kryera për subjekte publike dhe private, vendase dhe të huaja, si dhe ndaj studentëve; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palë të treta; donacione, dhurata, trashëgimitë; të ardhurat e krijuara nga veprimtaria kërkimore-shkencore; të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e mjediseve të cilat janë në administrim të UGJ-së, për palët e treta, në formën e kontratave të qiradhënies apo me forma të tjera kontraktimi, burime të tjera të ligjshme financimi). Njësia bazë financohet sipas planit të financimit institucional bazuar dhe në pikat 2 dhe 3 të nenit 99 të statutit të UGJ. Menaxhimi i planit të miratuar, kryhet nga Drejtoria e Shërbimeve Universitare, në varësi të kërkesave dhe nevojave të njësive.</p> <p>Evidenca IV.18, Evidenca IV.19, Evidenca IV.20, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 18</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Ndjekja e zbatueshmërisë së planit të financimit institucional dhe raportimet periodike financiare bëjnë të mundur vlerësimin e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raportet financiare përmbajnë detajime financiare si ato të financimit të burimeve njerëzore, si dhe të shpenzimeve të tjera sipas kategorive specifike. Gjithashtu UGJ-ja është objekt kontrolli nga institucionet kombëtare audituese si Kontrollit të Lartë të Shtetit por edhe vetë MAS. Këto auditime kryen sipas planit të punës që këto institucione kanë.</p> <p>RVB, Evidenca IV.18, Evidenca IV.19, Evidenca IV.20, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 18, Evidenca IV.32.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Gjithashtu DHAGJ dhe anëtarët e tij janë vënë në dijeni mbi financimet dhe mundësitë e përmbushjes së nevojave financiare të departamentit. Në zbatim të Statutit të UGJ-së, Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe administratori i UGJ kanë për detyrë të raportojnë për realizimin e buxhetit të miratuar</p>




buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	<p>në vitin paraardhës përpara Senatit Akademik të UGJ dhe Bordit të Administrimit. Këtë GVJ e konfirmoi edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Takimet në institucion, Evidenca IV.18, Evidenca IV.19, Evidenca IV.20.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Qëndrueshmëria financiare për zhvillimin e programevë të studimit të DHAGJ dhe departamenteve e tjera të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, realizohet në bazë të analizës financiare të financimeve dhe shpenzimeve të nevojshme në kontekstin e profilit të vet universitetit. Kjo qëndrueshmëri bazohet në financimet që akordon buxheti i shtetit dhe financimet nga të ardhurat dytësore si tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit, dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni. RVB. Takimi në institucion konfirmoi këtë konstatim si dhe evidentoi gatishmërinë në ndërhyrjet të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p> <p>Evidenca IV.18, Evidenca IV.19, Evidenca IV.20, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 18</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UGJ garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. Raporti vjetor financiar i kostove dhe mbështetjes financiare, i shërben mbarëvajtjes së programeve të studimit të UGJ, përfshirë në të dhe programin e studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”. Vihet re një bashkëveprim midis hallkave të institucionit me qëllim vlerësimin, realizimin e maksimalizimin e përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të DHAGJ.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--





V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Vizita në institucion, takimet me personelin akademik dhe autoritetet drejtuese, studentët si dhe vlerësimi i dokumentave bashkëshoqërues konstatojnë se UGJ harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe akteve rregullatore.</p> <p>Studentët njihen dhe aksesojnë informacione të nevojshme duke patur mundësi të barabarta midis tyre. Në ndihmë të tyre qysh në fillimet e studimit e në vazhdim u vihen në dispozicion materiale të tilla si: Udhërrëfyes për studentët, Manual shpjegues i Portalit U-Albania, Formular i regjistrimit të studentëve, plani mësimor i programit të studimit që do të ndjekin, informacion mbi përfitimin e bursave, mbi transferimin e studimeve dhe mobilitetet, veprimtari akademike dhe profesionale, njoftime të ndryshme eventuale etj. Materiale dhe informacione paraprake u vihen në dispozicion dhe studentëve kandidatë që dëshirojnë të ndjekin programin e studimit. Ky aktivitet informues realizohet nga personeli akademik, nga promovimi i departamentit, informimet nëpërmjet faqes online të UGJ, informime nga sistemet e brendshme menaxheriale, sektorët administrativ të rektoratit. Takimi me studentët konstatoi se ata ndjehen të barabartë dhe të mbështetur lidhur me informacionet e nevojshme që ata kërkojnë dhe marrin. Evidenca IV.29, Evidenca V.1, Evidenca V.2, Evidenca I.10.</p> <p>Pranimet e studentëve në UGJ, në të gjitha programet e studimeve bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me standartet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, kuotave dhe kriterëve të propozuara nga Njësia bazë si dhe legjislacionin në fuqi. RVB. E gjithë kjo procedurë është evidentuar qartë në aktet rregulluese të UGJ si: Statuti i UGJ, Neni 62; Rregullore e UGJ, Neni 49; Rregullore e UGJ, Neni 49; Rregullore e Njesisë bazë, Neni 32 pika 1; Urdhëra të QSHA dhe RASH për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit; dhe dokumentacioni mbi miratimin e kriterëve dhe kuotave; rregullore e programit të studimit.</p>


	<p>Evidenca I.1, Evidenca I.2, Evidenca I.20, Evidenca I.21, Evidenca V.3, Evidenca II.21, Evidenca II.22, Evidenca II.23, Evidenca II.24, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Evidenca I.10.</p>								
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti “Eqrem Çabej” ka mirëpasqyruar në dokumentacionin ligjor bashkëshoqërues, si: statuti i UGJ, kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë studimeve universitare. Dokumenta të tjerë rregullues janë Rregullorja e UGJ, Rregullorja e FESHSH dhe Rregullorja e DHAGJ të cilat rregullojnë praktikat informuese, politikat dhe procedurat e nevojshme, transparente dhe të barabarta për studentët kandidatë dhe ata të programit Bachelor në “Histori-Gjeografi”. Hulumtimi në faqen online të UGJ, tregon transparencën mbi kuotat e pranimit në këtë institucion, si dhe evidentimin e kësaj faqeje një burim i rëndësishëm i informacionit për politikat dhe procedurat nga hyrja deri në dalje për studentët dhe më gjerë.</p> <p>Evidenca I.1, Evidenca I.2, Evidenca I.20, Evidenca I.9, Evidenca I.21, Evidenca I.10, Evidenca V.1, Evidenca V.4, https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit</p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>GVJ konfrimon se UGJ harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Propozimet nga Njësitë bazë, përcillen në Rektorat dhe miratohen nga Senati Akademik. <u>Kriteret dhe Kuotat e Pranimit (uogj.edu.al)</u>. Tabela në vijim nxjerrë nga evidencat bashkëshoqërues qartëson kriteret e pranimit të studentëve dhe përqindjen e notës mesatare të maturës shtetërore dhe grup lëndëve disiplina bërthamë (pesha specifike e tyre).</p> <table border="1" data-bbox="571 1413 1369 1998"> <thead> <tr> <th data-bbox="571 1413 767 1805">Program i studimit</th> <th data-bbox="767 1413 978 1805">Nota mesatare e përgjithshme aritmetike e tre viteve të shkollës së mesme + Matura Shtetërore</th> <th data-bbox="978 1413 1177 1805">Pesha specifike sipas lëndëve të përcaktuara nga fakulteti për disipinat bërthamë</th> <th data-bbox="1177 1413 1369 1805">Pesha specifike sipas lëndëve (grup lëndët disipinat bërthamë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="571 1805 767 1998">Histori Gjeografi</td> <td data-bbox="767 1805 978 1998">50%</td> <td data-bbox="978 1805 1177 1998">50%</td> <td data-bbox="1177 1805 1369 1998">Histori 15% Gjeografi 15%</td> </tr> </tbody> </table>	Program i studimit	Nota mesatare e përgjithshme aritmetike e tre viteve të shkollës së mesme + Matura Shtetërore	Pesha specifike sipas lëndëve të përcaktuara nga fakulteti për disipinat bërthamë	Pesha specifike sipas lëndëve (grup lëndët disipinat bërthamë	Histori Gjeografi	50%	50%	Histori 15% Gjeografi 15%
Program i studimit	Nota mesatare e përgjithshme aritmetike e tre viteve të shkollës së mesme + Matura Shtetërore	Pesha specifike sipas lëndëve të përcaktuara nga fakulteti për disipinat bërthamë	Pesha specifike sipas lëndëve (grup lëndët disipinat bërthamë						
Histori Gjeografi	50%	50%	Histori 15% Gjeografi 15%						




				Qytetati 10% Shkenca Sociale 0.5% Arte 0.5%
<p>UGJ në programin Bachelor në "Histori-Gjeografi" parashikon edhe regjistrimin e studentëve të huaj. Në tre vitet e fundit kuotat kanë qënë të njëjta si në vijim:</p> <p>a) Kosova 1 kuotë b) Presheva 1 kuotë c) Bujanovci 1 kuotë d) Medvengja 1 kuotë</p> <p>Evidenca II.21, Evidenca II.22, Evidenca II.23, Evidenca II.24, VKM Nr. 436 "Për kriterin e mesatares", VKM Nr. 46 "Për kriterin e mesatares së përditësuar"</p>				
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Përmbushjen e këtij kriteri, institucioni e bazon në aktet ligjore dhe ato rregulluese (Rregullore e UGJ, Rregullore e studimeve të UGJ, Rregullore e FESHSH, Rregullore e DHAGJ), të cilat kanë evidentuar përcaktimin e kriterëve, procedurave të pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, ecurisë mësimore gjatë vitit akademik, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Këto akte ligjore dhe rregulluese janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku me disa mekanizma. Kriteret dhe informacionet për to janë lehtësisht të evidentueshëm në faqen online të UGJ. Afishimet në faqen online të UGJ dhe standat e njoftimeve, veprimtaria e Sekretarisë Mësimore FESHSH, dhe sistemi i Sekretarisë Mësimore Pitagora janë mbështetës në këto procese. Ndërkohë QSHA dhe RASH ndërveprojnë në këtë proces me UGJ.</p> <p>Vizita në institucion, RVB, Evidenca I.2., Evidenca I.9, Evidenca I.20, Evidenca I.21, https://uogj.pitagora.rash.al/, www.uogj.edu.al.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, përpara nisjes së tij UGJ-ja informon publikun dhe të interesuarit rreth kërkesave dhe kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. Kjo realizohet nëpërmjet disa mënyrave si: publikimit në faqen online të informacioneve të nevojshme dhe në rrjetet sociale, zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, organizimit të takimeve promovuese, me nxënës</p>			





<p>veçanta të programit të studimit.</p>	<p>maturantë të shkollave të mesme; fletëpalosjeve dhe posteratve; Panairit Work and Study, etj</p> <p>Evidenca V.5, Evidenca V.6, Evidenca V.7, Evidenca II.21, Evidenca II.22, Evidenca II.23, Evidenca II.24, Evidenca II.27, Evidenca II.28, Evidenca V.8, RVB</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UGJ parashikon kuota për kandidatë me aftësi të veçanta, konkretisht 2 kuota për persona me aftësi të kufizuara (bazuar në vendimet mbi miratimin e kriterëve dhe kuotave), <i>por nuk specifikohen kriteret specifike për përzgjedhjen e tyre, pasi pas aplikimit të tyre pranë IAL-ve, vendimarrjen e kryejne përsëri IAL-të.</i></p> <p>Evidenca V.3, Evidenca II.21, Evidenca II.22, Evidenca II.23, Evidenca II.24.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>UGJ parashikon kuota për kandidatë nga Republika e Kosovës, nga trojet shqipfolëse të shteteve të tjera si Maqedoni e Veriut, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë (Serbi), konkretisht nga 1 kuota për secilën (bazuar në vendimet mbi miratimin e kriterëve dhe kuotave), <i>por nuk specifikohen kriteret specifike për përzgjedhjen e tyre, pasi pas aplikimit të tyre pranë IAL-ve, vendimarrjen e kryejne përsëri IAL-të.</i></p> <p>Evidenca V.3, Evidenca II.21, Evidenca II.22, Evidenca II.23, Evidenca II.24.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ konfirmon se UGJ ndërmerr, harton dhe zbaton politika të ndihmës dhe dhënies së bursave për shtresat në nevojë dhe studentët ekselentë. Mbështetjet dhe dhëniet e ndihmës janë kryesisht në bursa dhe heqje të taksës së shkollimit në programet e mësuese.</p> <p>Evidenca II.5, Evidenca II.6</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ evidenton se UGJ harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve në programin e studimit. Dokumentacionet bashkëshoqëruese sqarojnë politikën, procedurat, mbështetjet ligjore, format e informimit dhe të mbështetjes financiare, si dhe mundësitë e përfshirjes në studime të kategorive në nevojë dhe të studentëve nga trojet shqiptare. Kujdes duhet treguar në përcaktimin e kriterëve specifike</i></p>




	<i>përzgjedhëse për kategorinë e studentëve me nevoja të vecanta apo ata nga trojet shqiptare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Në mënyrë të plotë dhe të hollësishme UGJ, FESHSH dhe njësia kryesore iu vë në dispozicion të studentëve informacion të hollësishëm, në lidhje me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin qysh që në vitin e parë të studimeve.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion vuri re se informacione të rëndësishme u viheshin në dispozicion dhe në stendat e njoftimit. Gjithashtu në çdo fillim viti dhe në çdo semester informohen për procesin mësimor të shtrirë gjatë vitit akademik, njihen me planin mesimor, orarin mësimor, ndërsa personeli akademik u jep informacion të detajuar për syllabuset, sesi realizohet ecuria e përparimit akademik, detyrimet lëndore, frekuentimin, format e kontrollit të dijeve të fituara, vlerësimine lëndore format e ankimimit. Dokumentacioni për këtë kriter paraqitet i bollshëm.</p> <p>RVB, www.uogj.edu.al, Evidenca I.20, Evidenca V.9, Evidenca I.2, Evidenca I.21, Evidenca I.9, Evidenca I.10, ANEKSTABELAT PËRMBLEDHËSE</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>UGJ i ka të përcaktuara kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Këto janë parashtruar në rregulloret e njësisë kryesore deri tek ajo e njësisë bazë apo të programit. Studentët njihen në fillim të vitit mbi mundësitë e njohjes së krediteve në kuadër të programeve të shkëmbimit (mobiliteteve) Erasmus+), të cilat realizohen nga DHAGJ. Sekretaritet mësimore dhe Komisioni i njohjes dhe i ekuivalentimit të lëndëve mësimore, informojnë dhe realizojnë procedurat e njohjes dhe ekuivalentimeve të lëndëve mesimore dhe krediteve përkatëse. Evidenca I.1, Evidenca I.2, Evidenca I.20, Evidenca I.10, Evidenca I.21, Evidenca V.4, Evidenca I.2, RVB</p>


<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni mbështetur në Rregulloret institucionale, ndërsa DHAGJ informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre, në programin e studimit. Kështu studentet informohen me format e vlerësimit të përparimit të tyre. Ato janë: vlerësim i vazhduar gjatë vitit (20%) dhe provimi final (80%). Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total, apo 45 pikë. Format e kontrollit të dijeve të evidentuara janë: vlerësim i povimit me shkrim, provim me gojë, vlerësim i projektit, kombinim i formave të mësipërme: me shkrim, me gojë dhe me projekt.</p> <p>Evidenca I.2, Evidenca I.9, Evidenca I.20, Evidenca I.10, Evidenca I.21.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit janë përcaktuar në rregulloret e: UGJ, të studimeve në UGJ, të FESHSH, të programit të studimit. Ciklin e parë të studimit, studentët e përmbyllur duke u diplomuar me provim përfundimtar formimi ose punim diplome. Ky prag ndarës i referohet mesatares së ponderuar të dy viteve të para të studimit, i cili për studentin që do të realizoj punim diplome, duhet të jete më i lartë se 8. (Rregullore e studimeve. Neni 59, Kreu VIII “Diplomimi”). DHAGJ ka procedura të qarta për mënyrën e asistimit të studentëve, duke filluar më miratimin e fushave të studimit për punimin e diplomës, takime informues mbi procedurat e diplomimit në fillim të vitit të fundit. Ndërsa udhëheqësit shkencorë, të cilët janë personeli akademik i programit të studimit, udhëzojnë dhe qëndrojnë pranë akademikisht studentit, për finalizimin me sukese te studimit dhe diplomimit në tërësi. E njehta ndihmesë konsistente u sigurohet dhe studentëve qe i përmbyllin studimet e tyre më provim të përgjithshëm përfundimtar. Takimi në institucion, Evidenca I.2, Evidenca I.9, Evidenca I.2, Evidenca I.20, Evidenca I.10, Evidenca II.18, Evidenca II.17, Evidenca II.19.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues dhe takimet në institucion me personelin akademik, studentët dhe GVB u konfirmua se UGJ përdor forma të ndryshme të informimit të të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm. Ndër to përmenden: spotet informuese televizive, shpërndarja e informacionit nëpërmjet fletpalosjeve dhe posterave, pjesmarrjet e UGJ në serinë e panairove “Work & Study”. Ndërsa zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit mbështet informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm në mënyrë të vazhdueshme. Evidenca V.5, Evidenca II.27, Evidenca II.28, Evidenca V.8, Evidenca V.6, Evidenca V.7, Evidenca II.25.</p>




ardhshëm mbi programin e studimit.				
Konkluzione	<p><i>UGJ vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi", informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit. Institucioni ka forma të ndryshme informimi, duke nisur nga informacionet që gjeneron vet departamenti, FESHSH, UGJ, stendat e informimit, faqja online e universitetit. Cdo fillimi viti dhe cdo semestër personeli akademik informon me infomacione mbi mënyren e ecurisë së përparimit akademik, detyrime lendore të nevojshme, ecurinë e vleresimit lendor etj. DHAGJ ka procedura të qarta për diplomimin e studentëve, duke filluar më miratimin e fushave të studimit për punimin e diplomës, takime informues mbi procedurat e diplomimit në fillim të vitit të fundit. E njejtja ndihmesë vlen për studentët që i përmbyllin studimet e tyre me provim të përgjithshëm përfundimtar.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>GVJ konstaton se studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit bachelor në "Histori-Gjeografi". Studentët njihen me rregulloret që funksionojnë në institucion dhe mundësitë e marrjes së informacionit nga to. Gjithashtu studentët informohen në mënyrë të hollësishme në takimet e fillim vitit akademik, gjatë të cilëve u jepet informacion i plotë rreth procesit mësimor, strukturës mësimore të vitit akademik, kohëzgjatjes së vitit akademik, sezoneve të provimeve, planit mësimor dhe lëndëve mësimore përkatëse, laboratorëve, bibliotekave dhe mundësive të aksesimit të infomacionit. etj.</p> <p>Takimi me studentët, takimi me personelin akademik, Evidenca I.2, Evidenca I.9, Evidenca I.20, Evidenca I.10, www.uogj.edu.al</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të	Bazuar në dokumentacionin shoqëruar, GVJ konstaton se UGJ dhe nënjesitë e tij, vënë në dispozicion të studentëve dokumentacion

<p>studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>institucional, nëpërmjet të cilave ata njihen dhe informohen për lëndët, modulet, përmbajtjen dhe veprimtarinë formuese. Rregulloret institucionale dhe programet lëndore (Syllabuset) janë dokumentat kryesore ku studentët njihen gjerësisht. Vizita në institucion dhe takimi me studentët konfirmojnë këtë konstatim.</p> <p>Evidenca I.9, Evidenca I.20, Evidenca I.10, Evidenca II.2, Evidenca II.3, Evidenca II.4.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UGJ nëpërmjet Zyrës së Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar informon, mbështet institucionalisht dhe orienton studentët mbi karrieren dhe mundësitë e punësimit. Pjesëmarrjet në panairë si ai “Work & Study” u krijojnë mundësi studentëve për informim dhe mundësi punësimi, ndërsa nënshkrimet e marreveshjeve me institucione të ndryshme kanë ndihmuar studentët në praktikat profesionale, dhe shihen si mundësi tjetër për punësim të studentëve.</p> <p>Evidenca V.10, Evidenca II.27, Evidenca II.28, Takim me studentët, Vizita në institucion, Evidenca IV.9, Evidenca II.26, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-Tabela 23, Evidenca I.31.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Takimi me studentët, me personelin akademik të DHAGJ dhe vëzhgimet në institucion konfirmojnë se studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij procesi nëpërmjet; Ata ndiheshin të informuar mbi përditësimet, zhvillimet e ndryshme që lidhen me procesin mësimor dhe kjo realizohej nëpërmjet formave të ndryshme si komunikimi nga personeli akademik, drejtuesja e njësisë bazë, nëpërmjet komunikimit në postën elektronike të studentit, faqes online të UGJ, etj.</p> <p>Evidenca I.10, Vizita në institucion, RVB</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, pikërisht në përmbajtjen e Nenit 22 pika 2 gërma a, b theksohen format e sigurimit të informacionit në lidhje me programin Bachelor në “Histori-Gjeografi”. Gjithashtu ai realizohet edhe përmes komunikimi me postën elektronike të studentit dhe pedagogut. Informacioni bëhet lehtësisht i arritshëm edhe nga studentët në distance.</p> <p>Evidenca I.10., www. uogj.edu.al, https://uogj.pitagora.rash.al/login</p>





studentët edhe në distancë.				
Konkluzione	<p>UGJ, DHAGJ vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi", rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit prej këtij program. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme rreth procesit mësimor, strukturës mësimore të vitit akademik, kohëzgjatjes së vitit akademik, sezoneve të provimeve, planit mësimor dhe lëndëve mësimore përkatëse, laboratorëve, bibliotekave dhe mundësive të aksesimit të informacionit. Rregulloret institucionale dhe programi lëndore (Syllabuset) janë nder dokumentat ku studentët njihen gjerësisht. Ndersa Zyra e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar mbështet institucionalisht dhe orienton studentët mbi karrieren dhe mundësitë e punësimit</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar, GVJ kontaton se UGJ disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve, në programin e studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi".</p> <p>Nga vrojtimi vërehet se studentë të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, sipas viteve janë:</p> <p style="text-align: center;">Viti akademik 2020-2021 3 studentë; Viti akademik 2021-2022 5 studentë; Viti akademik 2022-2023 15 studentë;</p> <p>Ndërsa studentë të diplomuar sipas viteve akademike janë si vijonë:</p> <p style="text-align: center;">Viti akademik 2020-2021 4 studentë; Viti akademik 2021-2022 6 studentë;</p>





	<p>Viti akademik 2022-2023 1 student;</p> <p>Evidenca I.1, Evidenca III.36, Evidenca IV.7, Evidenca II.26, Evidenca V.11. ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE tab. 21, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE tab. 23;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se UGJ disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve Bachelor në “Histori-Geografi”.</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion GVJ kontaton se ndërveprimi midis sekretarisë mësimore dhe studentëve të pamatrikulluar duhet të jetë më intensive në kohë, me qëllim finalizimin e rezultatit procedural. Kujdes duhet treguar në simbolikën e përdorur nga sekretaria mësimore.</i></p> <p>Vizita në institucion, vizita në sekretarinë mësimore, Evidenca I.13, Evidenca I.14, Evidenca I.15, Evidenca I.16, Evidenca I.17, Evidenca I.18, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konfirmon se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm Pitagora dhe më herët sistemi ESSE3. Gjithashtu, të dhënat ruhen manualisht në regjistrat përkatës, duke u menaxhuar nga Sekretaria mësimore. Të dhënat aksesohen nga personat e autorizuar; sigurohen dhe ruhen në bazë të regulloreve dhe akteve ligjore në fuqi.</p> <p>Evidenca I.1, Evidenca III.37, Evidenca III.26.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë</p>	<p>UGJ kryen kontrole periodike të dokumentacionit pranë Njësive bazë, Njësive kryesore dhe Sekretarive mësimore në mbështetje me akte ligjore. Në përfundim të tyre ai dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit, që lidhet me studentët si dhe me veprimtaritë e tyre dhe më pas bënë vlerësim dhe në varësi të rrethanave mban dhe qëndrimet përkatëse.</p> <p>GVJ konstaton realizimin nga ana e UGJ të kontrollit gjatë vitit 2022 (periudha e kontrolli: 31.01.2022-04.02.2022) me një strukturë të mirëpërcaktuar dhe raportohet gjendja nga kontrolli i kyer. <i>GVJ</i></p>




<p>mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p><i>rekomandon zbatueshmërinë e përvitshme të kontrolleve të tilla për të gjitha njësitë përgjegjëse.</i></p> <p>Evidenca V.13, Evidenca IV.10, RVB</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë harton raporte analitike mbi programin mësimor dhe plotësimin e objektivave mësimore të tij. Gjithashtu ajo raporton mbi cilesinë e hyrjes dhe daljes së studentëve dhe punësimin e tyre. Raportohen statistikatat e punësimit brenda dhe jashtë profilit të studimeve të programit Bachelor në “Histori-Gjeografi”.</p> <p>Evidenca I.13, Evidenca I.14, Evidenca I.15, Evidenca I.16, Evidenca I.17, Evidenca I.18, Evidenca II.26, ANEKSTABELAT PËRMBLEDHËSE</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UGJ mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Dokumentacioni mbështetës paraqitet i bollshëm dhe detajues dhe mbulon kriteret. Një vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet kontrolleve periodike të njësive institucionale dhe aspekteve administrative të sekretarisë mësimore gjatë procesit të matrikullimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	


Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e





përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>UGJ ka përcaktuar hapësirat e nevojshme mbështetur në Statutin e tij, për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Kështu Neni 88, pika 1, gërma b, i Statutit të UGJ, përcakton se studentët kanë të drejtë të: “Përfaqësohen në organet kolegjiale të UGJ-së në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe më këtë statut”, ndërsa gërma f, u jep atyre të drejtën që të organizohen për çështjet e tyre në nivel institucional, njësie kryesore apo njësie bazë. Bazuar në statut (neni 91), studentët mund të organizohen në organizmat e tyre, të cilat janë të pavarura dhe nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe partiake. GVJ konstaton se ata janë pjesë e Senatit Akademik të UGJ (masa 10% e përfaqësimit), Këshillit të Etikës (1 student), NJSBC (1 student), këshillat studentor, komisionet zgjedhore institucionale, dhe janë anëtarë të GVB. Janë të organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë Shoqatën Sportive Studentore. Gjatë vizitës në UGJ, GVJ konfirmoj faktet e mësimperme.</p> <p>Evidenca I.1, Evidenca II.38. Lista e anëtarëve të Senatit Akademik, Takimi me studentët në institucion,</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Pjesëmarrja dhe përfaqësimi institucional i studentëve, u krijon atyre mundësi të shprehen mbi procesin akademik (për planet mësimore, programet e studimeve, rregulloret e studimeve, etj) dhe të ndikojnë në vendimmarrje si psh: në cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, në zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, në ndarjen e burimeve financiare. Ata marrin pjesë si anëtarë në komisionet zgjedhore institucionale. Si dhe janë anëtarë të GVB për Akreditimin. Mendimet e tyre janë shumë të rëndësishme për institucionin dhe pyetësorët institucionalë shërbejnë si mekanizma të tjerë për t’i vjelë mendimet e tyre me qëllimin për reflektime në vendimmarrje.</p> <p>Evidenca I.1, Evidenca II.38, Evidenca V.14, Evidenca II.39, Evidenca II.40, Evidenca V.17, Evidenca III.26.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe</p>	<p>Në mbështetje të Statutit të UGJ, DHAGJ organizon punën për të garantuar që studentët të shprehin qëndrimet dhe propozime për planet dhe programet e studimeve; për rregulloret, veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, etj. Një formë e mbledhjes së mendimeve të tyre, janë diskutimet me ta, ajo e realizimeve të pyetësorëve me studentët, ku analiza dhe raportimi</p>





<p>përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>i tyre (ne raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorit) i vjen në ndihmë DHAGJ për përmirësime dhe ndërmarrjen e vendimeve konkrete. Një pyetësor i tillë mbi cilësinë e mësimit online është zhvilluar gjatë vitit 2022.</p> <p>Evidenca I.1, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Evidenca III.19, Evidenca III.20.</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konfirmon se studentët kanë mundësi të informohen dhe të japin mendimin mbi kryerjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Ata sqarohen në fillim të vitit rreth formave të vlerësimit dhe mundësisë për tu përfshirë në procesin e ankimit të rezultatit nga studenti. Madje procedurat janë të mirepërcaktuara në rregulloret e institucionit. GVJ evidenton procedurën e një ankese. Ajo bëhet me shkrim brenda afatit të ankimit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Dekani gjykon për ankesën e studentit nëse është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Në rast se gjykohet e drejtë, atëherë me propozim të Përgjegjës të Departamentit, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe ridhënien e provimit nga student.</p> <p>Evidenca I.2, Evidenca I.9, Evidenca I.20, Evidenca I.2, Evidenca I.9.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UGJ përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi", metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Ata janë pjesë e Senatit Akademik të UGJ (masa 10% e përfaqësimit), Këshillit të Etikës (1 student), NJSBC (1 student), këshillat studentor, komisionet zgjedhore institucionale, dhe janë anëtarë të GVB. Janë të organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë Shoqatën Sportive Studentore. Aktivizimi I tyre në organizime të tilla bën të mundur marrjen në konsideratë të mendimeve të studenteve, përfshirjen në vendimarrje lidhur me mirëfunksionimin e aktivitetit akademik dhe veprimtarisë tërësore studentore që lidhet me programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka njësi të posaçme në shërbim të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Këto njësi ndihmojnë studentët për nevojat dhe paqartësitë e tyre lidhur me programin e studimeve që ato ndjekin. Funkcionet informuese dhe ndihmuese të studentëve i kryen Sektori i Shërbimeve Bibliotekare Arkivore dhe Studentore (SSHBAS), pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademi-Administrative (DSHNA-A) e cila është në varësi të rektorit të UGJ</p> <p>Evidenca I.1, Statuti i UGJ, Neni 41. Ndërsa Zyra Juridike, u jep ndihmë punonjësve dhe studentëve për sqarimin e problemeve me karakter juridik. Evidenca IV.9. Neni 6, pika 4, gërma j. Për çështjet e këshillimit të studentëve për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, realizmin e bursave jashtë shtetit të kuadër të marrevëshjeve ndërshtetërore apo ndëruniversitare sipas programeve të bashkepunimit, ku UGJ merr pjesë, u vjen në ndihmë, zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni (ZKKA), nëpërmjet zyrës së Alumnit, këshillimit të karrierës dhe vlerësimit të vazhduar Evidenca IV.9. Neni 14. Neni 17, pika 7. Mbështetës të studentëve në informimin e tyre, janë dhe DHAGJ, Sekretaritë mësimore, Sistemi elektronik Pitagora, Zyra e IT, etj.</p> <p>Evidenca I.i. neni 42, Neni 43, Neni 44</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfrimoi mbështetjen institucionale</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin</p>	<p>UGJ, DHAGJ ka siguruar mbështetjen e studentëve ndaj kërkesave të tyre mbi çështje të procesit mësimor dhe programit të studimit. Kjo veprimtari është e mirërregulluar në aktet rregulluese: Rregullore e Njesisë Bazë, Rregullore e Programit të Studimit (Neni 22 - Informimi i studentëve cilëson format e informimit), Rregullore e Sekretarisë Mësimore (administron dokumentacionin e procesit mësimor parashikuar në nenin 101 të ligjit 80/2015). Drejtuesi dhe personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Histori – Gjeografi” në DHAGJ, informojnë studentët mbi përparimin e tyre dhe çështjet që lidhen me procesin mësimor, ndërsa Sekretaria mësimore mbështet me dokumentat e arkivuara dhe nevoja të tjera të natyrës arkivë-sekretari që lidhen me këtë marrëdhënie.</p>



<p>mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, takimin me studentët dhe personelin akademik të programit, studentët konfirmuan mbështetjen nga personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe organet drejtuese. Një pjesë të informacionit dhe këshillimit nga: ZKKA, sistemi elektronik Pitagora, rrjetet zyrtare sociale, faqja online e UGJ. Evidenca I.21, Neni 19, Evidenca I.10 Neni 22, Vizita në institucion.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në lidhje me dhënien e informacionit për orientimin e studentëve lidhur me zhvillimin e karrierës dhe zhvillimin e praktikave mësimore këtë detyrë realizohet nga zyra e ZKKA (Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit). Ajo informacion dhe orientim të posaçëm dhe gjithshka që kanë të bëjnë me procesin mësimor në UGJ, informacion për programet dhe kurrikulat e studimeve, orinetimet në tregun e punës. Mundëson informacione të mundshme të studentëve të ciklit Bachelor mbi mundësitë e studimeve në nivelin e dytë, gjatë të cilës janë të mundur praktikat profesionale. ZKKA e organizon veprimtarinë e saj në bazë të aktiviteteve, ku për secilin prej tyre përcaktohen objektivat, personat përgjegjës, grupi i interesit dhe afati kohor. Natyra e aktiviteteve për vitin 2022-2023 janë të natyrës: Info tour, informimi i aktiviteteve mbi karrierën në rrjete sociale, hartimi i CV dhe intervistave, takime të hapura, konferencë studentore, mundësi publikimi, trajnime mbi aftësitë komunikuese, takime me studentët e diplomuar, Panairi i punës, etj.</p> <p>Evidenca I.1. Statuti i UGJ, Neni 42, Evidenca IV.9, Rregullore DSHNA-A, Neni 14, Evidenca II.25. Plani vjetor i KKA 2022-2023.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e</p>	<p>Referuar Evidencës II.25 ZKKA në UGJ, harton planin e saj vjetor për gjurmimin e studentët pas diplomimit, grumbullon, përpunon dhe ruan të dhëna mbi nivelin dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe i vë në dispozicion të organeve drejtuese përkatëse. Nga të dhënat bashkëshoqëruese konstatohet se për vitin 2020-2021 janë diplomuar 4 studentë, dhe nuk janë punësuar studentë në përputhje ose jo me diplomën; në vitin 2021-2022 janë diplomuar 6 studentë, janë punësuar 2 në përputhje me diplomën dhe 1 jo në përputhje me diplomën; në vitin 2023 është diplomuar 1 student dhe është punësuar jo në përputhje me diplomën.</p> <p>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 23. Gjatë aktiviteteve të panairit të punës nëpërmjet procedurave të gjurmimit të studentëve merret vlerësimi mbi impaktin e njohurive të fituara në</p>





autoriteteve drejtuese përkatëse.	programin e studimit dhe vënien në zbatim të tyre. formular kontakti-Evidenca II.26, Evidenca II.27, Evidenca II.28			
Konkluzione	<i>Njësitë kryesore të UGJ, për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të studentëve janë: Sektori i Shërbimeve Bibliotekare Arkivore dhe Studentore (SSHBAS) kryen funksionet informuese dhe ndihmuese të studentëve. Ai është pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike-Administrative (DSHNA-A) në varësi të rektorit të UGJ, ndërsa zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni (ZKKA), orientohen dhe këshillohen mbi karrierë dhe vlerësimin e vazhduar. Zyra juridike ndihmon për ceshtje me karakter juridik. Vet DHAGJ, informon studentët mbi përparimin e tyre dhe çështjet që lidhen me procesin mësimor. Sekretaria mësimore asiston me dokumentat e arkivuara dhe nevoja të tjera të natyrës arkivë-sekretari. Sistemi elektronik Pitagora, Zyra e IT, faqja online e UGJ, plotësojnë ndihmesën në marrëdhënien student – universitet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të	Institucioni ka hartuar një udhëzues në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies, miratuar nga Senati Akademik me vendim Nr.28, datë 28.09.2023, pra fund i vitit akademik 2022-2023. Megjithëse e hartuar së fundi, SCK (Sektor i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave) e ka miratuar udhëzuesin mbështetur në qasjen e mësimdhënies me bazë studentin. Në të paraqiten orientime për metoda konkrete të mësimdhënies të cilat rekomandohen të përdoren nga personeli akademik sipas specifikave lëndore. Evidenca III.1.




<p>mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Megjithëse ky formalizim dokumentar është i vonshëm, GVJ gjatë takimit në institucion me personelin akademik dhe studentët të programit të studimit Bachelor në “ Histori-Gjeografi” konstaton se ata përdorin gjatë procesin mësimor, qasje didaktike të përditësuara bazuar në specifikat lëndore, si psh përdorimi i aplikacioneve dhe teknologjive mësimore (GIS, aplikacione për klimën, për lokacionin gjeografik të fenomeneve gjeografike, arkeologjike, të përpunimeve cilësore dhe sasiore brenda projekteve lëndore etj)</p> <p>Ndërsa për vitin 2020-2021, nën nevojat e situatës së pandemisë COVID-19, orientimet dhe miratimet nga Njësia Kryesore për Njësitë bazë perfshi dhe Njësinë Bazë Histori dhe Gjeografi, kanë qenë mbi përdorimin nga personeli akademik dhe studentët të platformave të mësimit në distancë, si Google Classroom, Zoom, Skype, Office 365, sistemi Pitagora.</p> <p>Evidenca III.2, RVB: Evidencat III.3-10 mbi manualat dhe implementimi i platformave të ndryshme, Evidenca II.16.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>SSCK (Sektor i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave) është stuktura e cila ka të përcaktuar qartë në Statutin e UGJ, ndër të tjera (Nenin 94, pika 5, gërma d, f, g) se: (d) kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore-shkencore, si dhe të aspekteve të tjera të lidhura me to; (f) planifikon organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional; (g) në fund të çdo semestri organizon pyetësorë studentorë për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo program studimi. Evidenca I.1. Neni 93-94</p> <p>Bazuar në dokumentacionin bashkeshoqërues GVJ konstaton se vlerësimi në bazë të pyetësorëve studentorë nuk realizohet periodikisht sipas përcaktimeve të statutit të UGJ. UGJ ka realizuar një pyetësor gjatë periudhës 11 Prill – 2 Maj 2022, mbi cilësinë e mësimdhënies online për vitin 2020-2021. Evidenca III.19-III.20.</p> <p>Ndërkohë institucioni organizon kontrole të vazhdueshëm, lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog (programet përkatëse të lëndëve, regjistrat etj), për një ecure sa më normale të gjithë procesit mësimor dhe shkencor, dokumentuar në raportet vjetore të UGJ dhe FESHSH. Evidenca I.13, Evidenca I.14, Evidenca I.15, Evidenca I.16.</p> <p>Krahas SSCK në UGJ funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi është e re dhe ka tri vite punë. Ajo është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e</p>





	<p>cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë. Kjo strukturë zbaton dhe ndihmon në përmirësimin të sistemit të cilësisë në UGJ. Për funksionimin e saj ka një rregullore Evidenca VI.1, por GVJ konstaton se bazuar në dokumentat bashkeshoqeruese nuk evidentojnë përmbushjen e këtij kriteri. <i>Manuali i Cilësisë në UGJ Evidenca VI.3. të cilën NJSBC e përdor në funksionalitetin e saj, konstatohet që është miratuar me Vendim të Senatit Akademik në dt 28.09.2023 duke evidentuar mungesë të mbështetjes së punës së kësaj strukture në këtë manual në tre vitet e fundit.</i></p> <p>Në raportet vjetore të DHAGJ nuk cilësohen mekanizmat e përdorur nga departamenti mbi monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Evidenca I.17, Evidenca I.18.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Pavarësisht se shprehja e mendimeve nga ana e studentëve nëpërmjet pyetësorëve studentore (jo periodike) është e kufizuar, GVJ gjatë takimit në institucion konkludoi se studentët nëpërmjet përfshirjes së tyre në organet institucionale universitare përcjellin vlerësimet e tyre, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, mbi performancën e personelit akademik, syllabuseve dhe programit mësimor, përfshirë procesin mësimor.</p> <p><i>GVJ rekomandon realizimin periodikë të pyetësoreve me tematikë mbi format e vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajnimit dhe ankimeve.</i></p> <p>Evidenca I.1, Evidenca V.17, Evidenca I.9.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimit mbi monitorimin dhe sigurimin e cilësisë paraqiten në raporte ku evidentohen gjetjet si psh raporti i pyetësorit të organizuar gjatë periudhës 11 Prill – 2 Maj 2022, mbi cilësinë e mësimdhënies online për vitin 2020-2021. Evidenca III.19-III.20. Rezultatet u bëhen të qarta njësisive bazë, gjetjet e të cilëve i diskutojnë në mbledhjet e departamentit duke vënë në dijeni personelin akademik.</p> <p><i>GVJ rekomandon monitorim të vazhdueshëm lidhur me çështjet e sigurimit të cilësisë në mësimdhënie dhe bërjen e gjetjeve të tyre sa më publike jo vetëm në raportet e njësisive kryesore dhe asaj bazë, por dhe për një publik më të gjerë të interesuarish, në kuadër të sistemit të Sigurimit të Bërsueshmë të Cilësisë.</i></p> <p>https://uogj.edu.al/transparenca, Evidenca I.1, Evidenca IV.11, Evidenca I.2, Evidenca I.13 – I.18</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet</p>	<p>UGJ, nëpërmjet të dhënave që disponon SSK dhe raporteve vjetore të këtij sektori ka synuar përmirësimin e veprimtarisë mësimore dhe të kërkimit shkencor të personelit akademik. <i>Veprimtaria e NJSBC</i></p>





mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p><i>është e zbehtë. Mbështetur në RVB dhe gjatë vizitës në institucion në takimin me përfaqësues të NJSBC u theksua intensifikimi i punës së NJSBC në vitet në vazhdim. <u>GVJ rekomandon strukturimin e mekanizmave të vlerësimit.</u></i></p> <p>Evidenca VI.4, Evidenca VI.5, Evidenca VI.6, Evidenca I.13-I.18.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se UGJ ka dokumenta rregullatorë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies; ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të mësimdhënies me në qëndër studentin si dhe manualin e cilësisë. Këto dokumenta janë hartuar dhe publikuar duke i ardhur në ndihmë institucionit në vitet në vazhdimësi. Monitorimi duhet të jetë periodik dhe sa më tematik. Standardi përmbushet kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në mbështetje të Nenit 103 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, UGJ ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. (SBC).</p> <p>Struktura, funksionimi i NJSBC (7 anëtarë, Evidenca VI.2) dhe i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK) përcaktohen në Statutin e UGJ, Strategjinë e Institucionit 2020-2025, Rregulloren e UGJ, Statutin dhe Rregulloren NJSBC. Evidenca I.1, Statuti i UGJ, Neni 93-94; Evidenca VI.1, Rregullore e NJSBC</p> <p>SSCK është pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndhmës Akademike-Administrative në varësi të Rektorit të UGJ Evidenca I.27.</p>




	<p>Në Statut dhe në Rregulloren e NJSBC, përcaktohen qartë gjithashtu politikat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. <i>Por miratimi i kësaj njësie (NJSBC) është realizuar në dt 28.09.2023, me Vendimin e Senatit Akademik Nr.24. dt 28.09.2023.</i></p> <p>Nga hulumtimi i dokumentacionit bashkëlidhur GVJ konstaton se vlerësimi periodik i veprimtarisë mësimore dhe asaj kërkimore shkencore realizohet nga SSCK si struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjithë njësitë përberëse dhe përmirësimin të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standartet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Evidence I.3, Evidence III.19, Evidence III.20, Evidence II.32, Evidence VI.4-6, Evidenca I.13-I.18</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin bashkëshoqërues UGJ dëshmon se funksionimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë mbështetet në veprimtarinë e SSCK e cila është ngritur dhe funksion në bazë të planifikimeve të saj vjetore. Ndërsa NJSBC është e ngritur së fundmi dhe funksionaliteti i saj do të vlerësohet në vijmësi. Kjo evidentuar gjatë vizitës në institucion dhe në RVB në të cilën theksohet se: <i>“Institucioni po punon për ngritjen dhe forcimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si një nga objektivat e Strategjisë së Institucionit 2020-2025. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet SSCK. Kjo Zyrë bashkëpunon dhe asiston komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore.”</i>Evidenca VI.1. Rregullore e NJSBC, Neni 3, Neni 4</p> <p>Nëpërmjet përfaqësimit në organizma institucional, studentët përfshihen në vendimarrje për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ndërsa ekspertët e jashtëm mund të anagazhohen në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit, për çështje të fushës së sigurimit të cilësisë.</p> <p>Evidenca I.31, Evidenca II.27, Evidenca II.28, Evidenca VI.3, Evidenca I.1. Statuti i UGJ, Neni 93 – 96.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë.</p>	<p>Ligji Nr. 80/2015, Neni 103, Neni 104 parashtron përgjegjësitë, mënyrat e vlerësimit për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, nëpërmjet sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në IAL-ve. Në UGJ, vlerësimi i brendshëm</p>




<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>i cilësisë është mbështetur në veprimtarinë e SSCK (Neni 93, Neni 94 Statuti i UGJ) dhe NJSBC (kjo e fundit organizuar së fundmi). Ndërsa sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë (Neni 104, Ligji Nr. 80/2015). UGJ i nënshtrohet procesit të vlerësimit, nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2019 dhe 2022, rezultatet e të cilit janë bërë publike prej ASCAL.</p> <p>UGJ ka kryer vlerësim periodik të institucionit brenda afatit kohor të vlefshërisë së tij dhe është në fazën e akreditimit të programeve të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Akreditimi i parë i UGJ shpallur me Vendim të BA Nr. 67, datë 21.09.2017, periudha: 21/09/2017 deri në 30/09/2020). • Vlerësimi periodik rezultuar me Vendim BA Nr. 55, datë 16.12.2021, periudha: 16/12/2021 deri në 15/12/2025. <p>UGJ në përmbushje të rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit, harton një plan veprimi i cili është miratuar me Vendim Senati Nr.15. Dt 03.06.2022. Ky plan veprimi i është përcjell ASCAL. Plan i veprimit detajon respektivisht: rekomandimet e BA, masat konkrete që do të ndërmerren nga UGJ, strukturat përgjegjëse dhe afatet kohore. Evidenca I.19.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësi, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>UGJ nëpërmjet sektorëve të saj përdor tregues si psh: pyetësor institucional dhe raportimet periodike semestrale apo vjetore për të pasqyruar gjendjen, arritjet dhe dobësitë të cilat parashtrihen në statut apo në rregullore, Evidenca I.1. Statuti i UGJ, Neni 95 pika 5, Rregullore e NJSBC, SSCK.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se format e promovimit nxitës janë të ndryshme si psh: promovim në komunitetin rajonal gjatë javëve të informimit, krijimi i lehtësive në publikim në Buletin shkencor të universitetit, mbështetje financiare në aktivitete shkencore si konferenca, simpoziume, përfshirja në projekte, përfshirja në organizimin e trajnimeve si trajnere, psh në trajnimet e organizuara nga Fakulteti i Edukimit etj. Nga GVJ forma të tilla promovimi konsiderohen pozitive dhe promotore të nxitjes për arritje më të mira.</p> <p>Evidenca I.13, Evidenca I.14, Evidenca I.15, Evidenca I.16, Evidenca I.17. Evidenca I.18.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UGJ harton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të</i></p>





	<i>strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Rekomandohet intensifikimi i veprimtarisë të NJSBC, si njësi e ngritur së fundmi. Vlerësohet pozitivisht ndermarrja e formave të ndryshme të promovimit të personelit akademik dhe përvojave të mira.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Raportet periodike vjetore të DHAGJ (2020-2021; 2021-2022) janë mekanizma formale të cilat vlerësojnë në mënyrë periodike programin e studimit. Evidencimet e arritjeve, dobësive, gjetjet e ndryshme të paraqitura në të bëhen pjesë e raporteve vjetore të FESHSH (2020-201; 2021-2022) dhe UGJ (2020-201; 2021-2022). Ato janë pjesë e dokumentacionit të evidencave që shërbejnë për akreditimin e programit dhe për akreditim institucional.</p> <p>Evidenca I.13, Evidenca I.14, Evidenca I.15, Evidenca I.16. Evidenca I.17. Evidenca I.18, Evidenca VI.4. Evidenca VI.5, Evidenca VI.6.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e</p>	<p>Raportet vjetore të SSCK (2020-2021, 2021-2022) dhe raportet vjetore të DHAGJ (2020-2021, 2021-2022) mundësojnë vlerësim mbi rezultatet e pritshme, evidentim të përfshirjes në</p>





<p>pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>praktika nxitëse dhe kërkimit shkencor të personelit akademik. Raportet vjetore të DHAGJ kanë synuar të parqesin informacione të qarta dhe transparentë të veprimtarisë së Departamentit në zbatim të misionit të tij, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; të prezantojnë elemente që lidhen me shërbimet që DHAGJ ofron; dhe të nxisin dhe të rrisin përgjegjësinë, llogaridhënien dhe sigurinë e cilësisë së shërbimeve që ofron Departamenti; të paraqesin problemet e konstatuara nga Departamenti, me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat shtetërore në fushën e arsimit. I gjithë ky raportim mbështetet në aktet ligjor në fuqi, urdhëra dhe udhëzime të përditësuara.</p> <p>Pyetësoret me studentët, gjurmimi i punësimit të tyre dhe diskutimet në departament për të, plotësojnë analizat vlerësuese për rezultatet e pritshme mbi përmirësimin në vijim të cilësisë, motivimin në mësim dhe kërkim.</p> <p>Evidenca VI.4, Evidenca VI.5, Evidenca VI.6, Evidenca I.13, Evidenca I.14, Evidenca I.15, Evidenca I.16. Evidenca I.17. Evidenca I.18</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimet paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Mbështetur në RVB, konstatohet se DHAGJ në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit mbikqyrin dhe monitorojnë respektimin e programeve të studimit, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera; ndjekin aktivitetin mësimor dhe shkencor të personelit akademik dhe vëzhgojnë studentët gjatë zhvillimit të seanceve laboratorike, praktikave në terren, detyrave të ndryshme apo testeve gjatë vitit akademik. Forma të tjera vlerësimi janë anketimi me studentët, diskutime të hapura, gjurmimi i ish-studentëve etj. Gjetjet vihen në shërbim të raportimeve vjetore institucionale.</p> <p>Evidenca VI.4, Evidenca VI.5, Evidenca VI.6, Evidenca I.13, Evidenca I.14, Evidenca I.15, Evidenca I.16. Evidenca I.17. Evidenca I.18, RVB</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të</p>	<p>GVJ konsaton se UGJ përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe dhe intervista të: studentëve dhe të</p>





<p>realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>diplomuarve; personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ; punëdhënëseve dhe institucioneve që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që shërbejnë për vlerësimin e dijeve dhe kompetencave të përfuara nga ky program si, realizimi i pyetësorit studentor 2020-2021, evidentimet në planin vjetor të KKA (2022-2023), të dhënat mbi diplomimin dhe punësimin e studentëve etj</p> <p>Evidenca III.20. Evidenca II.26. Evidenca II.25. ANEKSTABELAT PËRMBLEDHËSE-Tabela 23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve, Evidenca II.27, Evidenca II.28.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UGJ monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. UGJ përdor instrumente të ndryshëm si të dhëna nga raporte të ndryshme, anketime, diskutime me ish- studentë, të dhëna nga gjurmimi i studentëve, etj</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë</p>	<p>Statuti i UGJ, Plani Strategjik i Zhvillimit 2020-2025, veprimtaria e SSCK, NJSBC, organizatat studentor, zyra e Alumni, Këshillit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar (si promovuese e programit të studimit), garantojnë politikat dhe procedura të sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë së</p>




<p>përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>mesimdhënies angazhimit në kërkimin shkencor dhe zhvillimin cilësor të UGJ.</p> <p>Evidenca I.1, Evidenca I.27. Evidenca I.28. Evidenca VI.1, Evidenca VI.2, Evidenca II.27, Evidenca II.28. Evidenca II.26.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Të gjithë njësitë në UGJ individët, studentët dhe palët e interesura për sigurimin e brendshëm të cilësisë i ka detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në statutin e UGJ, dhe rregulloret e ndryshme si: ajo e DSHNA-A, NJSBC, RRegullore e UGJ, e FESHSH, dhe e njësisë bazë.</p> <p>Evidenca I.1, Evidenca IV.9., EvidencaVI.1, Evidenca I.2, Evidenca I.20, Evidenca I.21.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin bashkëshoqerues GVJ konstaton se anëtarët të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit përfshihen në organizma dhe procese të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit si psh janë pjesë e NJSBC, komisioneve të garantimit të cilësisë, kryerjen e anketimeve dhe dhënia e kontributeve të tyre në organizimet studentore etj. GVB,</p> <p>Evidenca I.1, Evidenca IV.9, Evidenca VI.1, Evidenca I.20. Evidenca I.21, Evidenca I.10, EvidencaV.17.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt</p>	<p>GVJ konstaton se proceset e vlerësimit bazohen në integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Veprimtaria e UGJ, përfshirë dhe aktorët e brendshëm që aktivizohen në proceset ciklike të vlerësimit udhëhiqen nga parimet si vijon: Liria e mendimit dhe e shprehjes; Liria akademike, autonomia financiare, organizative dhe e perzgjedhjes së personelit; transparenca; meritokracia; kolegjaliteti; mosdiskriminimi. Evidenca I.1, Neni 6. Gjithashtu aktorët e brendshëm të përfshirë në këto proceset e kanë të detyruar të respektojnë Kodin e Etikës se UGJ, ku në Kreun</p>




<p>personelit dhe studentëve.</p>	<p>III, Neni 8 (Njohja e meritës) dhe Neni 9 (Ndalimi i diskriminimit), përcaktohet sesi Universiteti njeh dhe promovon meritën individuale si për personelin akademik ashtu dhe për studentët. Në të theksohet e drejta për tu trajtuar në mënyrë të barabartë, me mirëkuptim, respekt, nderim; shmangiet e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, duke theksuar së është detyra e universitetit dhe e anëtareve të tij (pra aktorëve të brendshëm) të inkurajojë iniciativat e drejtuara në mbrojtje dhe vlerësimin ekategorive të pafavorizuara, ndryshimin individual dhe kulturor.</p> <p>Vizita në insitucion mbështeti evidentimin e sipërpërmendur, psh meritokracia në përfshirje në aktivitete shkencore, mbështetja financiare në zhvillimin profesional të stafit etj.</p> <p>Evidenca III.26, EVIDENCA III.37. Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm konsiderohet i rëndësishëm për UGJ dhe nënjësitë e tij. Format e sigurimit të vlerësimit kundrejt programit të studimit dhe universitetit në tërësi janë të ndryshme, duke përmendur: veprimtarine e SSCK dhe mundësisë së saj në angazhimin e ekspertëve të jashtëm për çështje specifike dhe/ose specialist të nivelit të lartë të fushës së sigurimit të cilësisë. <i>Nuk evidentohen/dokumentohen raste konkrete për pjesëmarrje aktive të ekspertëve të jashtëm për programin e studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi".</i></p> <p>Gjithashtu vlerësohet pozitivisht pjesëmarrja në panairin "Eork and Study", pasi nëpërmjet takimeve mes punëdhënësve publik dhe privat, si të interesuar për rekrutim në punësim, kuptohet realisht raporti mbi nevojat e tregut dhe atë çfarë programi dhe universiteti ofron. Nëpërmjet takimeve të tilla vilen mendime të rëndësishme në lidhje me cilësinë e programit dhe shihen mundësitë e përmirësimit të saj; ndërsa studentët kanë mundësi të konsolidojnë praktikisht njohuritë lëndore të fituara gjatë viteve të studimeve universitare.</p> <p><i>Në mbështetje të proceseve vlerësuese, <u>GVJ</u> sygjeron që bashkëpunëtorët dhe/ose ekspertët e jashtëm të mund të sigurohen nga institucionet publike dhe jopublike, më të cilat UGJ ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe qe operojnë në fushat e programit të studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi".</i></p> <p>Evidenca II.27, Evidenca II.28.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UGJ përfshin njësitë akademike, si SSCK, zyra e Alumnit, Këshillit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, DHAGJ, personeli akademik e studentët, partnerë dhe ekspertë të jashtëm,</i></p>




	<p><i>në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Në mbështetje të proceseve vlerësuese, <u>GVJ sygjeron që bashkëpunëtorët dhe/ose ekspertët e jashtëm të mund të sigurohen nga institucionet publike dhe jopublike, më të cilat UGJ ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe që operojnë në fushat e programit të studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi". GVJ konstaton se proceset e vlerësimit bazohen në integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</u></i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe në takimin me studentët, si dhe duke hulumtuar faqen zyrtare elektronike të UGJ, GVJ konstatoi se në kuadër të transparencës UGJ bën transparente politika, organizime dhe veprimtaritë në universitet përfshi dhe të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të institucionit, nënjësive të tij dhe më pak të programit të studimit (program i studimit Histori-Gjeografi) http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-histori-gjeografise/. Një seksion i vecantë i faqes online i është kushtuar transparencës: mbi akreditimin (informacion mbi NJSBC, Akreditimin institucional dhe Kodin e Cilësisë), zgjedhjet në universitet, raporte të auditit dhe buxhetit, njoftime punësimi dhe programi i transparencës.</p> <p>Studentët shprehën së bërja publike e informacioneve dhe krijimi i mundësisë për të aksesuar informacione në kohë reale lidhur me programin e studimit ka krijuar një facilitet të nevojshëm për ta. Infomacioni në nivelin e studimeve të ciklit të parë është i kufizuar</p> <p>http://www.uogj.edu.al/upload/plan%20programet/Bachelor%20ne%20Histori%20Gjeografi.pdf</p>





	<p>Megjithëse publikimet bazohen në Statut, Rregullore, vendime të Senatit Akademik, <i>GVJ sygjeron pasurimin e informacioneve konkrete për studentët dhe të interesuarit, në nivel të njësisë bazë.</i></p> <p>Evidenca I.1, Neni 60; https://uogj.edu.al</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstaton se UGJ harton disa lloje raportesh si: Raport i pyetësorit për procesin e mësimit online Prill-Maj 2022; Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Plan vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023; <i>por publikimi i tyre është i kufizuar ose mungon.</i> http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/</p> <p>Raportet respektojnë lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Publikimet respektojnë lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale</p> <p>Evidenca III.19. Evidenca III.20. Evidenca III.31, Evidenca VI.4, Evidenca VI.5. Evidenca VI.6, Evidenca III.37, Neni 29, Evidenca III.26.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Pas marrjes së vendimit të Akreditimit Periodik Institucional, UGJ ka hartuar një plan veprimi/ masash në të cilën janë paraqitur veprimi, kush është përgjegjësi për monitorim dhe zbatim dhe koha e realizimit. Evidenca 1. 19. Ato synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit e mësimdhënies si dhe mangësive të evidentuara.</p> <p>Evidenca III.34, Evidenca III.35. Evidenca VI.4, Evidenca VI.5, Evidenca VI.6. Evidenca III.1.13-18.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>SSCK ka vlerëson periodikisht duke hartuar raportet vjetore, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të UGJ. Edhe rekomandimet e lëna institucionit në kuadër të akreditimit institucional kanë shërbyer për përmirësimin e cilësisë së punës dhe ofrimit të shërbimeve dhe janë plotësuar nga institucioni.</p> <p>RVB. Evidenca VI.4, Evidenca VI.5, Evidenca VI.6</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmon se Institucioni nëpërmjet Njësisë bazë organizon takime, aktivitete, seminare informuese, ëorkshop-e me studentët, për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me impaktin e studentëve në përmirësimin e cilësisë së programit si dhe shërbimeve</p>




ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	administrative në institucion, aktivizim në pyetësorë, pjesëmarrje në Sondazhin Kombëtar të Studentëve etj. Evidenca I.1. Statuti i UGJ, Neni 60			
Konkluzione	<i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë pjesërisht publike, Ato janë transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë, por ato duhet të jenë më tepër përfaqësuese për programin e studimit</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	





Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Histori-Gjeografi” ofruar nga Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Cabej”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, është në përputhje me e veprimtarisë akademike, strategjinë dhe misionin e Universitetit “Eqrem Cabej”. Ai mbështet interesat e tregut të punës. Ai ofron një formim bazë të ekuilibruar duke mundësuar kompetenca të shumëfishta për t’iu përshtatur profileve të ndryshme të punës (histori, gjeografi etj.) **Standarti II.1. Konkluzion.** Siguron kapacitete humane të nevojshme, për rajonin jugor e më gjerë, I dalluar për vlerat e tij natyrore, historike, kulturore, të trashëgimisë botërore etj.
2. Universitetit “Eqrem Cabej”, siguron dhe garanton infrastrukturën fizike të nevojshme për zhvillimin me efikasitet të programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”. Godina ku gjendet DHAGJ, ofron kushte shume te mira të infrastrukturës fizike.
3. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor “Histori-Gjeografi” është i mirëkualifikuar në përzgjedhjen e tij, po ashtu dhe i përditësuar në aktivitetin mësimdhënës. Në këtë kontekst ai është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, si dhe didaktik në procesin e mësimdhënies, sipas tematikave dhe profilit. **Standarti III.1.4. Konkluzion**
4. Institucioni UGJ garanton mjedise të përshtatshme për punë laboratorike, për realizimin e praktikës, pranë DHAGJ, por dhe duke bashkëpunuar me institucione të tjera. **Standardi I.3; Konkluzione**
5. Laboratorët lëndorë dhe teknologjikë etj, mundësojnë realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Bachelor në Histori-Gjeografi dhe procesit të nxënies praktike. **Standarti IV.2; Konkluzione**
6. Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke synuar zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. **Standardi III.4; Konkluzione**
7. Përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimore. **Standardi II.6; Konkluzione**

Pika të dobta

1. Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ me IAL kombëtare publike dhe jopublike është shumë i vogël. **Standardi I.2; Konkluzione**
2. Në planin mësimor, kategoria e Disiplinës D nga përllogaritjet rezulton të jetë në përqindje më të vogël se pragu minimal, 9,4% nga (10-15%) që është në VKM Nr.41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË. **Standardi II.1; Kriteri 3.**
3. Numri i PAK që angazhon DHAGJ në raport me PAE është shumë i lartë, duke mos ruajtur raportin 70% me 30%.



4. Mungon një analizë e tregut të punës për këtë program studimi. **Standarti II.5; Konkluzione**


Rekomandime

1. Të rishikohet rishpërndarja e lëndëve me zgjedhje në të tri vitet akademike dhe midis semestrave për tu mundësuar studentëve të mos jenë të kufizuara vetëm në një vit akademik. **Standarti II.1; Kriteri 3**
2. Gjithashtu të përmirësohet pesha e e disiplinës D duke iu afruar vlerës së pragut referues sipas VKM Nr.41. **Standarti II.1; Kriteri 3.**
3. Të rishikohet programi mësimor me qëllim rritjen e peshës në kredite të praktikës mësimore, me qëllim paisjen sa më mirë të studentëve me kompetenca në përputhje me kërkesat e tregut të punë. **Standarti II.4; Konkluzione.**
4. Njësia bazë DHAGJ duhet të pasurohet me literaturë bashkëkohore, vendase dhe të huaj të pesë viteve të fundit. **Standarti II.4; Konkluzione.** Në këtë kontekst, nisur nga shqyrtimi i silabuseve, megjithese disa botime mund të jenë të domosdoshme dhe të rëndësishme për lëndën, pasurimi i njohurive akademike sygjerohet të kryhet me literaturë të përditësuar.
5. Të kryhet një analizë e tregut të punës për këtë program studimi. **Standarti II.5; Konkluzione.**
6. Të hartohen dokumenta rregullatorë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies periodik dhe sa më tematik. **Standarti VI.; Konkluzione.**
7. Të intensifikohet veprimtaria e NJSBC, si njësi e ngritur së fundmi. **Standarti VI.2; Konkluzione.**
8. Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë duhet të jenë më teper përfaqësuese për programin e studimit. **Standarti VI.5; Konkluzione.**
9. Ti kushtohet vëmendjeje kontrolleve periodike të njësive institucionale dhe aspekteve administrative të sekretarisë mësimore gjatë procesit të matrikullimit. **Standarti V.4; Konkluzione.**

Conclusions from the evaluation of the First-Cycle Bachelor Study Program in "History-Geography" offered by the University of Gjirokastra "Eqrem Çabej"

Strengths and Affirmations

1. The Bachelor study program in "History-Geography" aligns with the academic activity, strategy, and mission of the "Eqrem Çabej" University. It supports labor market interests and offers a balanced foundational education, enabling multiple competencies to adapt to various job profiles (history, geography, etc.). **Standard II.1. Conclusion.** It ensures the necessary human capacities for the southern region and beyond, distinguished by its natural, historical, cultural, and world heritage values.




2. The "Eqrem Çabej" University ensures and guarantees the necessary physical infrastructure for the effective development of the Bachelor study program in "History-Geography." The building housing DHAGJ offers excellent physical infrastructure conditions.
3. The academic staff engaged in the Bachelor study program "History-Geography" is well-qualified in their selection and up to date in their teaching activities. In this context, they are competent in explaining knowledge and concepts as well as didactic in the teaching process according to the themes and profile. **Standard III.1.4. Conclusion.**
4. The UGJ institution guarantees suitable environments for laboratory work, the realization of practice, at DHAGJ, and through collaboration with other institutions. **Standard I.3; Conclusions.**
5. The subject-specific and technological laboratories, etc., facilitate the teaching process of the Bachelor study program in History-Geography and the practical learning process. **Standard IV.2; Conclusions.**
6. The study program guarantees the enhancement of creative and practical skills in students, aiming at the deep development of professional and scientific competencies in students. **Standard III.4; Conclusions.**
7. Involvement of students in research activities. **Standard II.6; Conclusions.**

Weaknesses


1. The number of collaboration agreements between UGJ and national public and non-public higher education institutions is very small. **Standard I.2; Conclusions.**
2. In the curriculum, the percentage of Discipline D is below the minimum threshold, 9.4% compared to (10-15%) as stipulated in VKM No.41, dated 24.1.2018, FOR THE ELEMENTS OF STUDY PROGRAMS OFFERED BY HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS. **Standard II.1; Criterion 3.**
3. The number of part-time academic staff (PAK) engaged at DHAGJ in relation to full-time academic staff (PAE) is very high, not maintaining the 70% to 30% ratio.
4. There is a lack of labor market analysis for this study program. **Standard II.5; Conclusions.**

Recommendations

1. Review the redistribution of elective courses across the three academic years and between semesters to ensure students are not limited to only one academic year. **Standard II.1; Criterion 3.**




2. Additionally, improve the weight of Discipline D by approaching the reference threshold value according to VKM No.41. **Standard II.1; Criterion 3.**
3. Review the curriculum to increase the credit weight of teaching practice, with the aim of better equipping students with competencies in line with labor market demands. **Standard II.4; Conclusions.**
4. The DHAGJ base unit should be enriched with contemporary literature, both domestic and foreign, from the last five years. **Standard II.4; Conclusions.** In this context, based on the syllabus review, although some publications may be essential and important for the subject, the enrichment of academic knowledge is suggested to be done with updated literature.
5. Conduct a labor market analysis for this study program. **Standard II.5; Conclusions.**
6. Develop regulatory documents to ensure and promote the quality of periodic and thematic teaching. **Standard VI.; Conclusions.**
7. Intensify the activities of NJSBC, as a newly established unit. **Standard VI.2; Conclusions.**
8. The policies, processes, and activities for Internal Quality Assurance should be more representative of the study program. **Standard VI.5; Conclusions.**
9. Pay attention to periodic checks of institutional units and the administrative aspects of the academic secretary during the matriculation process. **Standard V.4; Conclusions.**



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË			X	




STUDIMIT BACHELOR				
VLERËSIMI TËRËSOR				X

